



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Prill 2008 • Viti XXV • Nr. 4 (163) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



**ALFABETI
EVROPIAN I SHQIPES
Në Zagreb u shënua
100-vjetori i Kon-
gresit të Manastirit**

FAQE 5

(Shkruan:
FRROK KRISTAJ)



**JETA
BASHKËSHORTORE
NË SHEKULLIN E
KOMUNIKIMIT**

FAQE 9

(Shkruan:
P. SHTJEFËN DODES SJ)



**MITROVICA ME
RRETHINË DHE E
KALUARA HISTORIKE
E KËSAJ TREVE**

FAQE 4

**JUSTINI I ROMËS,
FILOZOF DHE
MARTIR
(100 – 165)**

FAQE 8

(Shkruan:
DON MARJAN DEMAJ)



Papa Benedikti XVI gjatë fjalimit para Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara

■ KËNDVËSHTRIM

Njihe vetveten!

Njihe vetveten” (*Gnothi seauton*) është këshillë urtësie, i skalitur me shkronja të arta në hyrje të tempullit në Delfi, në Greqinë antike. Çdo ndërrim për të mirë, çdo psikoterapi e suksesshme, duhet të fillojë nga gjendja faktike, nga e vërteta lakuriqe, sado të jetë ajo e dhimbshme apo e rëndë. Ka pak njerëz që e njohin, vërtet, vetën e tyre. Në përgjithësi, ne njerëzit, kemi njohje sipërfaqësore, të pasurit e një shikimi të asaj çfarë bëjmë dhe si sillemi. Porse, thellësitë e qenies sonë, motivimet tona të nënvetëdijshme që na ngrehin në lëvizje, mbesin shpeshherë të fshehura e të panjohura. Për ta njohur vetveten duhet të përsiasim jo vetëm *çfarë* bëjmë, por edhe *pse* e bëjmë: të tentosh të zbardhësh motivet e fshehura, të fshehura në thellësi e që na nxisin në veprim.

Mjetin e përsosur në procesin e njohjes së vetvetes e gjejmë në përshpirtërinë tonë përmes *rrëmbimit të ndërgjegjes*. Kjo është metodë e privilegjuar e hyrjes në thellësi të shpirtit dhe zbulimit të shkaqeve për të kuptuar sjelljet dhe veprimtarit tona. Nuk ka përparim të vërtetë në jetën tonë shpirtërore pa reflektim, pa përshkim të thellë të zemrës. Kush e bën, ditë për ditë, rrëmbimin e ndërgjegjes, është në përparësi për të mos përsëritur gabimet dhe marrëzitë, mëkatet, që i ka bërë në të kaluarën. Çdoherë që pendohemi për mëkatet dhe lëshimet tona, njëkohësisht shprehim vendosmërinë për të mos i përsëritur ato. Edhe pse të njëjtat i bëjmë përsëri, për shkak të dobësisë dhe lëndimit të natyrës sonë, megjithatë do pritët progres nëse në përditshmëri bëjmë rrëmbimin e ndërgjegjes e më shpesh vendosim për t'u ruajtur prej tundimeve dhe mëkateve.

Jezusi është psikoterapeuti më i mirë, sepse Ai e njeh deri në palcë natyrën/shpirtin e njeriut, e përshkon thellësinë e zemrës së njeriut dhe i njeh motivet e veprimit të tij. Ai do të na ndihmojë për ta njohur sa më mirë vetveten. Ta ndihmosh dikë për ta njohur vetveten më mirë e më thellë, është vepër e dashurisë dhe respektit ndaj atij personi. Në këtë mënyrë Jezusi e ka treguar veprën e madhe të dashurisë dhe respektit ndaj nxënësit të tij Pjetrit kur e ka ballafaquar me vetveten, përkatësisht me atë tjetrin, me Pjetrin e brendshëm që e mbante në thellësi të zemrës, e të cilin Pjetri i jashtëm nuk e njohte. Në Darken e Mbrame Pjetri donte ta bindte Jezusin, se është i gatshëm për të të shkojë edhe në vdekje se sa ta tradhtojë. Atëherë Jezusi i tha: “Për të vërtetë, po të them: sot, pikërisht sonte, para se të këndoje gjeli dy herë, tri herë do të më biesh mohit.” (Mt 14, 30). Është e qartë se Pjetri nuk e njohte vetveten. Ai sinjersisht ka shprehur vendosmërinë për të vdekur për Jezusin, por në zemrën e tij ende nuk ishte i gatshëm për të vuajtur dhe vdekur, për këtë arsye edhe në momentin e tundimit e ka tradhtuar. Vetëm pas tradhtisë qau me lot për faqe, e njohu vetën sa i ligshat ishte. Jezusi, pra, i ndihmoi ta njohë më mirë vetën, në atë mënyrë që ia zbuloi të vërtetën mbi të, përkatësisht dobësinë e tij.

Parimi i parë “*njihe vetveten*”, më së miri do ta zbatojmë nëse veten e njohim në të vërtetën e plotë, e cila thotë se njeriu është mëkatar, të cilin e do Hyji. Kjo është e vërteta e parë për ne njerëzit. Nëse duam të jemi të singertë me vetveten, atëherë duhet ta pranojmë se jemi mëkatarë, që çdo ditë bëjmë mëkate e marrëzi; diç të keqe bëjmë për shkak të së keqes që jemi, e diç për shkak të natyrës sonë të kufizuar. Bibla ka të drejtë kur thotë se “s’ka njeri që nuk mëkaton”, se i drejti mëkaton shtatë herë në ditë. Porse, duhet shtuar se njeriu nuk është vetëm mëkatar, por para së gjithash fëmijë i dashur i Hyjit, mëkatar që e do Hyji.

Në psalmin 139 theksohet e vërteta se vetëm Hyji mund ta përshkojë deri në fund njeriun, vetëm Hyji nga larg i njeh mendimet →



**Shqiptarët katolikë
në/dhe marrëvesh-
jet diplomatike –
Konkordatet – të
Vatikanit me Ju-
gosllavinë (I)**

FAQE 17

Shkruan:
Zef AHMETI

Intervista me Dr. Hajredin Kuqin

**Kushtetuta e Republikës
së Kosovës garanton
lirinë dhe të drejtën e
besimit**

FAQE 12–13



tona. Fjalët e këtij psalmi, kur i lexojmë me fe dhe shpresë në provaninë e Hyjit, kanë fuqinë për të sjellë në shpirt paqen e plotë dhe gëzimin e vërtetë. Psalmi në fjalë përfundon me klithmën e sinqertë, që do të duhej të përsëritet për të mos gabuar rrugën e vërtetë: "Shiko në mos ka në mua udhë kotësie dhe më kthe në udhën e amshueshme." (Ps 139, 24).

Shumë jetojnë në iluzion duke menduar se janë pa mëkat, për shkak se nuk besojnë në dashurinë e pamasë të Hyjit: nuk mund të kuptojnë se Hyji i do edhe atëherë kur janë mëkatarë, kur ia kthejnë shpinën Atij. Jezusi na ka treguar në mënyrë gjeniale këtë të vërtetë në shëmbëlltyrën e djalit të humbur, i cili duke jetuar i dhënë pas vesesh, larg prej

babait, kishte shkapërdërdhur gjithçka që i kishte dhuruar i ati. Porse, kur ky kthehet në shtëpi, babai ia fal me zemërgjerësi të gjitha dhe urdhëron të bëjë banket të madh, sepse "pati vdekur e u ngjall, pati humbur e u gjet" (Lk 15, 32). Me këtë shëmbëlltyrë të djalit të humbur, përkatësisht të Atit zemërgjerë që fal, Jezusi na ka treguar se si nuk duhet të merakosemi e të frikohe mi ta pranojmë se jemi të humbur kur largohemi prej Hyjit, porse kjo e vërtetë s'duhet të na mbyllë në botën tonë të paafëtisë, përkundrazi, të dalim nga vetvetja për t'u prirë kah Ati qiellor, me bindjen se do të na i falë të gjitha e me zemërgjerësi do të na pranojë në shtëpi.

Prof. dr. Pater Mijo Nikić SJ
Përktheu: Don F. Koliqi

Lajmet shkurt

EMAUS me familjet e meshtarëve dhe rregulltarëve

Këtë vit shtegtimin e Emausit për meshtarët dhe rregulltarët e Kosovës, ipeshkvi i Dodë Gjergji e ka organizuar pak më ndryshe, duke i ftuar edhe familjarët e të gjithë të shuguruarve dhe të kushtuarve të Kosovës, në një Meshë të përbashkët. Ishte ky një përjetim i veçantë për të gjithë nga që ishte hera e parë kur prindërit, motrat, vëllezërit tanë, mund të festonin së bashku me ne dhe të ndiheshin të privilegjuar e krenarë që në një mënyrë shumë të posaçme janë pjesë e Kishës së shenjtë. Meshën e kremtoi Mons. Doda me më se 20 meshtarë. Ai ua drejtoi fjalën e tij të rastit sidomos prindërve, duke i falënderuar për dhuratën e jetës dhe lutjes. Gjithashtu edhe famullitari i Bishatazhinit, don Rrok Gjonllesha, u uroi mirëseardhje të gjithëve dhe i ftoi që pas meshës të bëheshin pjesë e drekës së përbashkët të përgatitur bashkë me vendasit. Grupi i të rinjve nga Sapa (Shqipëri), ishin të ftuar special. të cilët i kënduan disa këngë kishtarë me instrumentet popullore dhe kështu e mbanin atmosferën edhe për vallet popullore. Ishte ky një rast i shkëlqyer për t'u dhënë mundësi të gjithëve ta shijojnë begatinë e thirrjes së Zotit në mesin e të gjithë atyre që Ai vetë i ka thirrur dhe të mund të njihen e të shoqërohen mes vete. Takimet e tilla zgjojnë dëshirën dhe vullnetin për t'u lutur Zotërisë së të korrave të dërgojë punëtorë në vreshtin e vet.

M. Teuta Augustini

Festa e ngritjes së Jezu Krishtit në qiell - Shëlbuesit në Berdosanë

Të enjten, më 1 maj, në filialin e famullisë së Doblibares, në Berdosanë u kremtua festa e të Ngriturit të Jezu Krishtit në qiell apo festa e Shëlbuesit. Si gjithë një në këtë filiale befasuan pozitivisht prania e konsiderueshme e popullit dhe devotshmëria e tyre ndaj Zotit tonë Jezu Krishtit. Këtë prani e zbukuronte edhe peizazhi i gjelbër, kodrinor dhe me pamje mahnitëse të pranverës. Meshën kryesore të orës 11:00 e udhëhoqi dr. don Lush Gjergji, famullitar i Katedrales së Prizrenit. Ai në predkun e tij, duke zbërthyer Fjalën e Zotit, theksoi rëndësinë e historisë së shëlbimit dhe të Veprës Shpërbëlimtare të Jezu Krishtit. Famullitari i kësaj famullie don Kolë Thaqi, shprehu gjithë kënaqësinë e tij dhe falenderimet Zotit, meshtarëve dhe të gjithë të pranishmëve. Meshtarët dhe të gjithë të pranishmit u pranuan me gëzim nga famullitari dhe familjet e ndryshme që të vazhdojnë festë edhe në tryeza vëllezërore.

Don Jeton Thaqi

Maria është dera përmes së cilës Biri i Hyjit erdhi në botë

Me rastin e festës së famullisë "Zoja e Këshillit të mirë", në Klinë, u festua edhe 25-vjetori i kësaj famullie

Në Klinë, me datën 26 prill, në praninë e mijëra besimtarëve dhe një numri të madh meshtarësh, u kremtua festa e famullisë "Zoja e Këshillit të Mirë". Meshën shenjte e celebroi Don Marjan Marku, misionar në Zvicër me disa meshtarë të ipeshkvisë sonë. Në fillim të meshës, të pranishmit i përshëndeti famullitari i kësaj famullie Don Lenc Sopi, i cili tha: "Dhashtë Zoti të jemi të bashkuar çdoherë, kështu si sot, në këtë tempull të Zojes, me një numër kaq të madh, dhe ardhë koha që tempujt tanë mos t'i zënë numrin e madh të besimtarëve".

Edhe pse me një kohë të vranët dhe pakëz me shi, numri i besimtarëve ishte i madh. Ata kishin vërshuar nga të gjitha anët e Kosovës dhe e kishin stërmbyshur kishën dhe oborrin e saj.

Don Marjani në prektun e meshës kapi temën e ungjillit të asaj dite - mrekullinë e Jezusit në Kanë të Galileës, përkatësisht ndërmjetësinë dhe këshillimin e Zojes në atë rast dhënë kujdestarëve të tryezës. Këtu më poshtë po i japim vetëm disa inserte të prektun: "Maria është dera përmes së cilës Biri i Hyjit erdhi në botë. Nëse përmes derës hyjmë në një Kishë, atëherë e kuptojmë përse Maria vendoset nëpër portalet e kishave. Ajo na prin tek Jezu Krishti, duke u bërë dera jonë përmes së cilës ne

arrijmë mu te Jezusi. Në dasmën e Kanës së Galileës Maria me fe të plotë u pati thënë shërbësve: "Bëni gjithçka t'ju thotë" - Gjn 2, 5. Nga kjo pjesë e Ungjillit, Marinë e shohim si këshilltare e mirë, e cila na udhëzon tek Jezu Krishti. Këtu Maria na paraqitet si derë përmes së cilës Jezu Krishti na paraqitet në botë me mrekullitë e tij duke e ndriçuar pushtetin e tij Hyjnor dhe mrekullibërës". Mandej don Marjani shtoi: "Kur Hyji bëhet njeri, atëherë ai se bashku me ne feston dasmën Hyjnore dhe në këtë mënyrë jeta e jonë fiton një shije dhe kuptim të ri dhe Hyjnor". Për simbolikën e enëve të verës në dasmë u tha: "Gjash-të enët e gurit janë shenjat e jetës sonë, të cilat tregojnë ditët e punës, kurse ena e shtatë na udhëzon tek zemra e hapur e Jezu Krishtit. Po ajo Mari, e cila qëndron pranë kryqit të Krishtit, dëshiron të na tregojë se vdekja dhe ringjallja e Krishtit është për ne një rilindje e re dhe kalimi në jetën e vërtetë dhe të amshuar. Jezusi nga kryqi i pati thënë nxënësit të tij më të dashur Gjonit: ja merre me vete Marinë në shtëpinë tënde, skenë e cila ka mbetur çështje mistike për eterit e kishës. Krishti ngjashëm na drejtohet edhe neve që sot e gjithmonë ta marrim Marinë në shtëpitë tona, mësimin e saj hyjnor. Pra përmes këtij mësimi e portali të saj shpirtëror ne hyjmë

dhe dalim përmes derës qiellore duke përdoruar pastrim Hyjnor për të lindur përsëri. Duke e marrë për shembull jetën e Marisë, ne forcohem në fe dhe dashurinë e Zotit, duke e lejuar atë që të kalojë përmes pragut të jetës sonë kështu që edhe ne të bëhemi Tempulli i Hyut. Dyert hapen për t'u mundësuar takimi me të afërmin tonë. Kuptimi me thelbësor i derës është hyrja e Hyut në zemrën tonë që së bashku me Të ta festojmë dasmën Hyjnore".

Në fund të meshës famullitari don Lenc Sopi në emër të motrave dhe kapelanit Don Anton Ukajt dhe të gjithë ndihmësve që kishin kontribuar për këtë festë, i falënderoi përzemërsisht të pranishmit dhe besimtarët duke vënë një theks të veçantë për Don Marjan Markun, i cili kishte ardhur nga kurbeti i largët për të bashkëmësuar me vëllezërit e tij.

Më pas në shenjë të vitit jubilar u recitua një poezi nga studenti Luz Balaj, kushtuar historikut të kësaj famullie, ku ne pah u vu edhe figura e don Frane Sopit, i cili në ato kohë të vështira veprimi në këtë famulli për 24 vite rresht.

Dhe krejt në fund famullia kishte përgatitur një drekë vëllezërore për meshtarët, motrat dhe për disa mysafirë të tjerë.

Vilson Culaj



Festa e Zojes së Këshillit Mirë në Klinë 2008



Mons. Hil Kabashi gjatë liturgjisë në Meshë

E kremtja e shën Nikollës në Velezhë

Me dallim me vitet e kaluara, në këtë vit, festa e Shën Nikollës u festua në të djelën para datës së nëntë majit, për shkak të festës së Rrëshajve që bintë në të dielën pas. Edhe në këtë vit festa e pajtorit të famullisë së shën Nikollës në Velezhë u festua me një solemnitet jashtzakonisht të madh. Duke ju falë nderit Zotit për kushtet atmosferike të shkëlqyeshme, falë organizimit të mirë nga ana e famullitarit të kësaj famullie don Franë Kolës, bashkpunëtorëve të tij dhe besimtarëve të kësaj famullie, duke ju falënderit korit të udhëhequr nga motra Violeta Lleshdedaj, falë numrit të konsiderueshëm të besimtarëve dhe shtegtarëve nga të gjitha viset e ipeshkvisë sonë, kjo festë që një gëzim për të gjithë.

Meshën pontifikale e drejtoj ipeshkvi i Administratës Apostolike të Vlorës, në Shqipëri, dhe biri i kësaj famullie mons. Hil Kabashi. Së bashku me ipeshkvin koncelebruan edhe shumë meshtar të ipeshkvisë sonë e sidomos të dekanatit të Prizrenit. Gëzimin e kësaj feste e rriti edhe prania e gjeneralit të forcave të Kfor-it në Kosovë Xsavier De Marnach, i cili shprehi vullnetarisht dëshirën të marrë pjesë në këtë festë dhe të ndaj gëzimin me të pranishmit. Gjeneralit ju bashkangjiten edhe disa pjestarë të Kfor-it francez, gjërman dhe ata të Kfor-it austriak me seli në bazën Casa Blanca në komunën e Therandës.

Në predikimin e tij, mons Hil Kabashi, foli shkurtimisht për jetën dhe shëmbullin e shën Nikollës. Ai u paraqiti besimtarëve shëmbullin dhe jetën heroike të ipeshkvit, shënjtit dhe mrekullbërsit me prejardhje nga Greqia dhe që jetën e vet si bari e shkriu

në Azinë e vogël dhe me përkatësisht në Turqinë e sotshme. Duke pas para sysh edhe ngjarjet tragjike që ndodhën në famullinë tonë, në Velezhë, ai ftoj besimtarët dhe të gjithë njëzëit vullnetmirë të jenë paqëndashës, të falin njëri tjetrin, të shërojnë plagën e hakmarrjes dhe të konflikteve të pa nëvojshme. Ai me tutje theksoj edhe plagët e tjera të popullit tonë shqiptar, siq ësh-

te braktisja e vendit dhe dëshira e madhe për tu pasuruar me të shpejt dhe ndoshta jo me shumë ndjersë por, përmes rrugëve jo të mira dhe ilegale. Ai uroj të pranishmeve edhe pavarësinë e vendit dhe njëherit ftoj që tani e tutje të jenë të pavarur edhe në një pavarësi tjetër drejt rrugës të së mirës.

Famullitari i kësaj famullie don Franë Kola, njëherit edhe

vikar gjeneral në ipeshkvin tonë, falënderoj ipeshkvin, gjeneralin dhe të gjithë të pranishmit duke ju uruar edhe besimtarëve këtë festë të shënjtë. Kjo festë përfundoj edhe me sofrën vëllazërore që të ftuarëve ua shtroj famullitari i kësaj famullie.

Festa e shën Kollit, pesë ditë me vonë, me datë, u kremtua edhe në filialën e kësaj famullie në Sallagrazhdë. Atje meshën

kryesore e udhëheqi famullitari i Doblibarës don Kolë Thaqi. Edhe në këtë filial u ndie gëzimi dhe hareja e madhe e kësaj feste me praninë e një numri të konsiderueshëm të miqëve dhe dashamirëve të kësaj filiale. Ashtu me gëzim u prit dhe u dëgjuan edhe fjalët shumë tingëluese dhe entuziaste të predikatarit.

Don Jeton Thaqi

Pjesëmarrësit në Meshë me rastin e Festës së Shën Nikollës në Velezhë



Simpozium shkencor mbi lashtësinë e qytetit të Mitrovicës dhe rrethinës

Mitrovica me rrethinë dhe e kaluara historike e kësaj treve

Në Mitrovicë më datë 19 prill, duke ia filluar që nga ora 10:00, në sallën e Shtëpisë së Kulturës "Rexhep Mitrovica" u mbajt simpoziumi me karakter shkencor: "Mitrovica gjatë shekujve me rrethinë". Simpozium u organizua nga Kisha Katolike e Mitrovicës në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Mitrovicës. Në këtë tubim ishin të ftuar studiues të njohur nga Kosova, të periudhave dhe ngjarjeve të ndryshme historike, të cilët me kumtesat e tyre shpalosën dhe ndriçuan të kaluarën historike të Mitrovicës me rrethinë. Në simpozium morën pjesë ipeshkvi i Kosovës Imzot Dodë Gjergji, kryetari i Kuvendit Komunal të Mitrovicës zotni Bajram Rexhepi dhe imami Asllan Murati, përfaqësues të KFOR-it dhe OJQ-ve e intelektualë të tjerë të rrethit.

Tubimin e hapi organizatori i këtij sesiioni, famullitari i kishës katolike të Mitrovicës don Pashk Dani, i cili falënderoi për praninë e tyre në tubim Imzot Dodë Gjergjin si dhe kryetarin e komunës së

Mitrovicës Bajram Rexhepin. Tubimin e tillë don Pashk Dani e cilësoi si një përpjekje për ndriçimin e disa vlerave historike arkeologjike, gjeografike e kulturore të Mitrovicës dhe rrethinës si një vendbanim i vjetër. "Ky tubim është një nismë në përpjekjet për ndriçimin e vlerave të trashëguara nga e kaluara, sepse angazhimet nuk do të mungojnë as në të ardhmen në organizmin e aktiviteteve të formave të ndryshme, tha në fund të fjalës së tij don Pashk Dani. Ipeshkvi i Kosovës imzot Dodë Gjergji, në fjalën e tij përshëndetëse para të pranishmeve, tha se përmes gjuhës së dialogut duhet të komunikojmë me qytetërimin dhe t'i pasqyrojmë vlerat e ndryshme të civilizimit. Imzot Dodë Gjergji theksoi se gjuha e dialogut shpreh mënyrën më të mirë të tolerancës, se toleranca nuk duhet të jetë vetëm si një fjalë e zbrazët, apo utopi, po, si një mundësi reale e komunikimit në mes njerëzve për të krijuar relacione humane. Ndërsa, kryetari i komunës së Mitrovicës zotëri Bajram Rexhepi, shprehu vlerësimin

e tij për këtë tubim si një ngjarje të rëndësishme për Mitrovicën, e cila ka qenë e banuar që nga periudhat e hershme. Sipas Rexhepit, organizatori dhe pjesëmarrësit e këtij tubimi po i bëjnë një respekt të veçantë Mitrovicës dhe qytetareve të saj, duke ndriçuar vlera nga e kaluara. Ai falënderoi Ipeshkvin e Kosovës, Kishën Katolike në Mitrovicë dhe famullitarin e kësaj kishë për organizimin e këtij sesiioni.

Tubimi në Mitrovicë ishte konceptuar në dy pjesë, në programin shkencor dhe në atë muzikor. Në programin shkencor u lexuan kumtesat nga historianët dhe studiuesit e fushave të ndryshme. Në fillim të këtij sesiioni prof. dr. Jahja Drançolli paraqiti kumtesën e tij "Kontributi i Kishës Katolike për Pavarësinë e Kosovës". Drançolli në kumtesën e tij përmes fakteve të shumta shpjegoi se shqiptarët janë ndër popujt e parë në Evropë, që flakën politeizmin duke avancuar në monoteizëm, pranuan krishterimin duke institucionalizuar edhe jetën kishtarë, si në treva tjera e po ashtu edhe në Kosovë. Ai theksoi rolin dhe kontributin e Kishës dhe të klerit katolik dhënë çështjes shqiptare në përgjithësi dhe pavarësisë së Kosovës në veçanti. Me kumtesa tjera u paraqitën: prof dr. Adem Zëjnullahu – Vrasja e Konsullit Rus në Mitrovicë – Atentat politik; prof dr. Xheladin Shala – Isa Boletini, figurë e denjë kombëtare dhe mbarekombëtare; prof dr. Bektesh Vidishiçi – Mitrovica gjatë mesjetës – zanafilla dhe zhvillimi i vendbanimeve të Mitrovicës; prof dr. Rexhep Doçi – Kishat Katolike dhe Ortodokse të Kosovës me zanafillë iliro-shqiptare; prof dr. Fazli Hajrizi – Zhvillimi i arsimit në Mitrovicë. Ndërsa kumtesa e dom Pren Kolës ishte "Relacionet ndërreligjioze në shërbim të paqes"/ Po ashtu u referua dhe kumtesa e Pajazit Hajrizit, "Vllahija në shekuj (Antika dhe Mesjeta)". Në përfundim të këtij sesiioni u zhvillua edhe një debat përmes pyetjeve nga publiku dhe përgjigjeve të dhëna nga ana e referuesve. Me fjalën e tij në këtë tubim u paraqit edhe imami Asllan Murati, i cili e çmoi rolin e organizatorit dhe punën e referuesve në ndriçimin e vlerave nga e kaluara. Ai shfaqti synimin për bashkëpunimin dhe krijimin e një

klime sa më të favorshme në mes të komuniteteve fetare.

Kumtesat e lexuara në këtë sesiion, reflektonin domethënien, se pavarësisht prej periudhave dhe regjimeve nëpër të cilat ka kaluar Kosova, ngulitja e religjionit të krishterë dhe fryma e proveniencës perëndimore i ka lënë gjurmët e saj edhe sot e kësaj dite në të gjitha trevat e vendit tonë, si në aspektin e civilizimit e po ashtu edhe në aspektin kulturor.

Ky tubim u begatua edhe me një program kulturor të zhanrit të muzikës serioze. Në këtë program interpretuan pjesë nga veprat e kompozitorëve botërorë dhe shqiptarë: Festim Haxhikadriu, Leonora Shkreli-Bekteshi, Vullnet Kurti, Fisnik Komtrashi, Jeta Koshi, Liridona Brahrimi, Elbenita Kajtazi, Linda Hakaj, si dhe Marigona Qerkezi me këngën "I will always you".

Pal Canaj



Don Pashk Dani përshëndet pjesëmarrësit në Simpozium



Ligjëruesit në Simpozium



Ipeshkvi Imzot Dodë Gjergji gjatë fjalës së tij të rastit



Kryetari i komunës së Mitrovicës Dr. Bajram Rexhepi përshëndet të pranishmit në Simpozium

Në Zagreb u shënua 100-vjetori i Kongresit të Manastirit

Alfabeti evropian i shqipes

Organizuar nga Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci dhe Këshilli i Pakicës Kombëtare Shqiptare të Zagrebit, u mbajt simpoziumi në të cilin u paraqitën 10 kumtesa nga njohësit e krijimit të alfabetit të shqipes. Bartësit e kumtesave ishin nga Kosova, Shqipëria, Sllovenia, Zvicra dhe Rumania

■ SHKRUAN:
Frruk KRISTAJ

Në Zagreb të Kroacisë u mbajt simpoziumi me karakter ndërkombëtar kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit. Këtë simpozium e organizoi Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci në bashkëpunim me Këshillin e Pakicës Kombëtare Shqiptare të qytetit të Zagrebit. Simpoziumin e shpalli të hapur dhe i përshëndeti pjesëmarrësit Dr. Luigj Daka, kryetar i Këshillit të Pakicës Kombëtare Shqiptare të Zagrebit, kurse atë e kryesoi Don Ndue Ballabani, udhëheqës i Misionit Katolik Shqiptar në Kroaci, i cili që në fillim tha se atdhetarët që përqeshin të bashkonin popullin kishin përpara një përçarje në popull që shkaktohej nga politika 'përçaj e sundo' e qeverisë osmane, pastaj nga struktura shoqërore feudale-fisnore në Shqipëri, si dhe drejtimet e huaja të grupeve të ndryshme fetare, të cilat përdornin turqishten, greqishten, italishten etj., në vend të shqipes. Në ato kushte, shoqëria "Bashkimi" e Manastirit thirrri më 14 nëntor 1908 Kongresin e parë të përgjithshëm për diskutimin dhe miratimin e një alfabeti të njësuar.

Dhe, kjo histori do të vijojë të flasë për atë çfarë ndodhi në Manastir 100 vjet më parë. Delegatët shqiptarë (150 sish) nga vende të ndryshme, vendosën që shqipja të shkruhej me alfabetin latin.

Në këtë simpozium shkencor ndërkombëtar u paraqitën dhjetë kumtesa nga studiuesit e vendeve të ndryshme të viseve shqiptare e shteteve tjera evropiane, si nga Shqipëria: Dr. Tomor Osmani (*Alfabeti i shqipes nga Formula e Pagëzimit deri në Kongresin e Manastirit*), Dr. Koleç Topalli (*Parimet themelore të hartimit të alfabetit të shqipes*) e Dr. Enkelejd Shkreli (*Kongresi i Manastirit dhe vlerat akustike të tingujve të shqipes*); nga Kosova: Dr. Jahja Drançolli (*Kontributi i Kishës Katolike në rezultate e Kongresit të Manastirit*), Dr. Muhamet Mala (*Rrethanat historiko-shoqërore në Shqipëri në kohën e Kongresit të Manastirit*) e Frruk Kristaj (*Abetarja e Zymit dhe ABC-ja e Kongresit të Manastirit*); nga Sllovenia Dr. Martin

Berishaj (*Alfabeti i shqipes si diskurs identitar*); nga Zvicra Dr. Mehmet Elezi (*Alfabeti latin – dëshmi e qytetërimit evropian të shqiptarëve*) e Mr. Albert Ramaj (*Kongresi i Manastirit sipas disa dokumenteve të Arkivit shtetëror të Austrisë*) dhe nga Rumania Akademik Kopy Kyçyku (*Dy dialekte – një gjuhë*).

Me këtë rast ndër të tjera u tha se në nëntor të vitit 1908, në Manastir të Maqedonisë u mbledh kongresi që shpalli alfabetin e gjuhës shqipe të cilin e trashëgojmë sot. Për çudinë e shkencës tonë, të parët që përkujtojnë një jubile të madhërisëm si ky, është Misioni Katolik shqiptar në Kroaci dhe Këshilli i Pakicës Shqiptare në Zagreb të Kroacisë.

Përndryshe, u tha në simpozium se pjesëmarrësit e Kongresit të Manastirit atëbotë ishin përcaktuar që krahas alfabetit që ne kemi sot, të përdorej për njëfarë kohe edhe alfabeti i shoqërisë "Stambolli" që kishte një traditë dhe që kjo ishte zgjidhje kompromisi. Koha tregoi se alfabeti që u caktua në Manastir, ishte jo vetëm më i përshtatshëm për gjuhën shqipe, po edhe më praktik për botimin e librave në të gjitha shtypshkronjat e vendeve perëndimore. Alfabeti turkoarab që ishte përdorur deri në atë kohë në disa shkrime, sidomos në ato të bejtexhinjve, natyrisht ishte i papërshtatshëm, sepse nuk mund të mendohej në asnjë më-

nyrë që gjuha shqipe të shkruhej me shkronja arabe. Këtë nuk e ka asnjë nga gjuhët e Evropës, prandaj, shqiptarët duke qenë në Evropë, çka e kuptuan fort mirë intelektualët e shquar të kohës, gjetën rrugën më të përshtatshme që ishte pikërisht alfabeti me shkronja latine. Të mos harrojmë se këtë alfabet e kanë përdorur

kuara, shkolla shqipe nuk mund të ecte përpara, librat nuk do ta kishin vlerën e tyre, pa një alfabet të vetëm. Zgjidhja e këtij problemi mund të konsiderohet si hapi i parë vendimtar drejt pavarësisë kombëtare të popullit tonë.

Kësisoj gjetja e alfabetit latin ishte në vazhden e traditës më të hershme që kishte ndjekur vetë

Shqiptarët duke qenë në Evropë, çka e kuptuan fort mirë intelektualët e shquar të kohës, gjetën rrugën më të përshtatshme që ishte pikërisht alfabeti me shkronja latine. Të mos harrojmë se këtë alfabet e kanë përdorur jo vetëm gjuhët neolatine, po edhe ato gjermanike, madje edhe gjuhët joindoevropiane të Evropës siç është hungarishtja apo finlandishtja dhe ishte jashtë mendjes që shqipja të dilte nga kjo rrymë e gjuhëve të Evropës.

dorur jo vetëm gjuhët neolatine, po edhe ato gjermanike, madje edhe gjuhët joindoevropiane të Evropës siç është hungarishtja apo finlandishtja dhe ishte jashtë mendjes që shqipja të dilte nga kjo rrymë e gjuhëve të Evropës.

Në këto rrethana, kur lëvizja jonë për çlirim kombëtar ishte në rritje, kur lindte nevoja e botimeve të librave në gjuhën shqipe, kur reaksioni shtonte përpjekjet për të penguar çdo nismë përparimtare në të mirë të kombit shqiptar, një pengesë serioze ishte mungesa e një alfabeti të vetëm për shqipen. Kështu gjuha nuk mund të lëvrohej në nivelet e kër-

shkrimi i gjuhës shqipe. Libri i parë i gjuhës shqipe, që është "Meshari" i Gjon Buzukut, është shkruar pikërisht me shkronja latine. Po të shkojmë edhe më tutje, Formula e Pagëzimit, më 1462, është shkruar po ashtu me shkronja latine, dhe kjo kishte krijuar një traditë e cila u sanksionua dhe u bë e ligjshme në Kongresin e Manastirit. Me këtë rast të gjitha ato rajonalizma dhe pikëpamje fetare që mbështeteshin tek ortodoksia sllavo-greke, nuk qenë të qenësishme në këtë Kongres, për arsye se bëhej fjalë për një alfabet të të gjithë shqiptarëve dhe u bë më e

mira, meqenëse në drejtim të këtij komisioni pati njerëz vërtet të përgatitur, siç ishin: Atë Gjergj Fishta, Mithat Frashëri, Don Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi e të tjerë, përkatësisht gjuhëtarë dhe jo gjuhëtarë.

Nga kjo del se para plotë 100 vjetëve, në Manastir, u hartua një alfabet që do të merrte elementët më të mirë të shoqërive kulturore që kishin hartuar alfabetet dhe kishin bërë njëfarë jete me botimin e librave, gazetave e revistave të tyre. Pas shumë përdorimeve të alfabetëve të lindjes dhe atij grek, tashmë shqiptarët kishin vendosur të bashkoheshin me vendet e tjera të Evropës Perëndimore, për të shkruar gjuhën e tyre me këtë alfabet. Kaq vite më vonë, studiuesit ndajën bindje të ndryshme mbi këtë eveniment. Por ajo çfarë i bashkon këto bindje është fakti se ai moment hodhi hapa të rëndësishëm në krijimin e letërsisë sonë. Albanologët e njohur të shqipes e vlerësojnë këtë vendim si njërin nga treguesit që shqiptarët kishin vendosur në fillimin e shekullit XX që të orientoheshin nga Evropa. Pra, alfabeti është një tregues drejt orientimit nga Perëndimi, përdorimi i alfabetit latin, dhe jo alfabetit arab, është një tregues që shqiptarët e panë që ishin në Evropë, e panë një lidhje me Evropën dhe ishin vitet e fundit kur shqiptarët donin të shkëputeshin nga perandoria osmane.

Do theksuar se mbajtja e simpoziumit në Zagreb paraqet aktivitetin e parë që zhvillohet në këtë vit jubilar, të 100-vjetorit të hartimit të alfabetit të gjuhës shqipe, të alfabetit që shënon dhe një gur themeltar për kulturën shqiptare. Ky është një jubile i papërsëritshëm, sepse me këtë alfabet jo vetëm u shënua një hap përpara për shkrimin e mijëra e miliona librave të shkruara nga ajo kohë e që vazhdojnë të shkruhen edhe sot, por njëkohësisht ai ishte dhe një shenjë e qartë e bashkimit të të gjithë shqiptarëve kudo ndodheshin, pasi me këtë alfabet të shqipes shtypen të gjitha librat në të katër anët e rruzullit tokësor. Alfabeti i gjuhës shqipe është një krijim vërtet i përsosur, sepse është shfrytëzuar përvoja më pozitive e të gjitha alfabetëve të gjuhëve të zhvilluara të Evropës.



Don Ndue Ballabani, misionar në Kroaci



Tomor Osmani

Vështrim teologjik – pastoral

Detyrat bazë të Kishës dhe

Krishti është drita e popujve. Krishti e ka themeluar Kishën të jetë një sakrament, e kjo do të thotë shenjë për bashkim të ngushtë me Zotin si dhe për bashkimin e mbarë njerëzimit (khs. LG, nr. 1). Kisha i njeh 4 detyrat apo porosinë themelore, përmes të cilave njihet dhe dëshmohet porositja e Krishtit në çdo bashkësi veç e veç dhe si e tillë ajo është e pranishme në botë. Këto katër detyra apo porosi janë: Liturgia, Martyria, Diakonia, Koinonia

■ SHKRUAN:
Don Kolë GJERGJI

Detyra e kishës, e të krishterëve, konsiston në dhënien e dëshmisë për Lajmin e Gëzueshëm, për Ungjillin „d.m.th. ta harxhosh jetën në çdo mënyrë për shkak të besimit (Martyria). Mandej, detyra tjetër thelbësore është kremtimi i eukaristisë, pranimë reale sakramentale të Jezusit Krishtit (Liturgia); dashuria konkrete vepruese ndaj të afërmit, përkatesisht shërbimi në njerëzit tjerë duke e bërë të ndjeshme dhe të pashme këtë dashuri (Diakonia); dhe, në fund, krejt veprimtaria si tërësi e të krishterit, si dëshmi, kremtim dhe shërbim zbatohet në bashkësinë e pagëzuarve në komunikim me njëri-tjetrin (Koinonia).

Pra, Kisha është një bashkësi e besimtarëve, vlerave, detyrave dhe e dëshmisë. Të krishterët takohen për çdo të diele – apo edhe për çdo ditë në kishat e veta për të kremtuar Meshën e shenjtë në përkujtim të Darkës së Mbrame, atë Darkë që Jezusi e shtroi me nxënësit e vet në të Enjten e Madhe. Nga ky kremtim buron shërbimi në dashuri ndaj njeriut vëlla e motër, buron guximi për ta shpallur këtë dashuri deri në fund.

vera në shndërrim bëhen Trup dhe Gjak i Krishtit. Liturgia, kremtimi i shërbesës së Zotit është për të parët e kishës një ushqim i përbashkët. Kjo bashkësi e tryezës ishte vazhdimësi e bashkësisë së sofrës në Darkën e Mbrame të Jezusit Krishtit (khs. Mk 14, 17-25; Vap 2,43-47). Bashkësia në tryezë është një shenjë që njerëzit njëri-tjetrin e pranojnë dhe secili që merr pjesë është i pranuar si person, në këtë prani e ndajnë njëri me tjetrin me dashuri.

Shërbesa e Zotit (Liturgia) e posaçërisht kremtimi eukaristik i meshës, bëhen pra „burimi dhe kulmi i krejt jetës së krishterë“ (khs. LG, nr. 11). Në meshën e shenjtë bashkësia e besimtarëve „kërcen“ nga përditshmëria dhe e bën të përtueshme jetën në të vërtetën e Zotit. Mesha e shenjtë shndërrohet në dhuratë për besimtarët. Përpjesëtimet e madhe të eukaristisë, ekzistojnë tek ne edhe forma tjera të liturgjisë: si p.sh.: sakramentalet, shërbesat e fjalës, lutjet personale dhe të përbashkëta, përkushtimet e ndryshme, meditimet, shtegtimet e shumë të tjera. Në liturgji bën pjesë edhe kremtimi i sakramenteve. Sakramentet janë shenja të dukshme vepruese që Zoti na i ka dhuruar për shëlbimin

dëshmi, dhe martyrs = dëshmitar)

Me „martyria“ nënkuptojmë shpalljen dhe dëshminë e Lajmit të gëzueshëm – Ungjillit të Jezusit. Përkthimi i fjalës martyria nënkupton dhënien e dëshmisë. Kështu, martirët janë ata të cilët me dëshminë dhe me bindjen e tyre të qëndrueshme, shkuan edhe deri në vdekje për Jezusin dhe në këtë mënyrë u bënë dëshmitarë të fesë. Kërkesa për të dhënë dëshmi për fenë, nuk është një çështje private, por gjithmonë edhe një bindje e përgjithshme e të gjithë të krishterëve.

Ndoshta sot të krishterët nuk janë shumë të martirizuar për vdekje në Evropë, por në vendet tjera të botës ndodh, nëse njihen apo edhe paraqiten si të krishterë. Kështu ata ballafaqohen me sharje, përbuzje, torturë dhe ndoshta me dënim me vdekje. Në qoftë se dikush sot e pranon veten si të krishterë, kërkohet këtu një fuqi e madhe e fesë, sepse nuk ballafaqohet njeriu gjithmonë dhe gjithkund me vlera të mëdha.

Në shumë vende të cekura në Bibël, luten besimtarët që të japin dëshmi dhe të tjerët t'i entuziazmojnë për Jezu Krishtin dhe për Ungjillin e Mbretërisë së Zotit. Kështu besimtarët janë të ftuar në letërnë e parë të shën Pjetrit apostull: „Jini gjithmonë të gatshëm t'i jepni përgjegje gjithsecilit që prej jush kërkon arsyen e shprehës që është në ju, por me butësi dhe me nderimin e dubur, me ndërgjegje të mirë, në mënyrë që ata, që flasin keq për jetën tuaj në Krishtin, pikërisht në atë pikë, në të cilën juve ju shpifin, të mbesin të turpëruar“ (1 Pjt 3,15-16). Po ashtu edhe në të ashtuquajturin „urdrin e misionit“ në ungjillin sipas Lukës, i Ringjalluri kërkoi në prej nxënësve: „Prandaj, shkoni e bëjini nxënës të mi të gjithë popujt! Pagëzoni në Emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt! Mësojini të zbatojnë gjithçka ju kam urdhëruar! Dhe, ja, unë jam me ju gjithmonë – deri në të sosur të botës!“ (Mt 28, 19-20).

E ngjashme është për ta kuptuar kërkesën e Jezusit në ungji-




“Martyria nënkupton dhënien e dëshmisë. Kështu, martirët janë ata të cilët me dëshminë dhe me bindjen e tyre të qëndrueshme, shkuan edhe deri në vdekje për Jezusin dhe në këtë mënyrë u bënë dëshmitarë të fesë. Kërkesa për të dhënë dëshmi për fenë, nuk është një çështje private, por gjithmonë edhe një bindje e përgjithshme e të gjithë të krishterëve.”

llin sipas Mateut (Mt 10,6-18), ku prej nxënësve kërkohet ta marrin mënyrën e jetës, të veprojnë dhe nëpërmes predikimit edhe të zbatojnë. Shkruarja pas Jezusit do të thotë gjithmonë një dëshmi dhe hyrje konsekvante për „gjërat e Jezusit“, që është Mbretëria e Zotit. Çdo i pagëzuar është pjesëmarrës në dërgimin e Krishtit në Kishë dhe nëpërmjet Kishës dhe kjo pjesëmarrje e bën Kishën e gjallë. Kjo kishë ka nevojë për fuqi, entuziazëm dhe ideale, që të mund të depërtojë Ungjilli edhe në strukturat sociale, e t'i shndërron zemrat e njerëzve dhe të shoqërisë dhe të mund të lind një kulturë njerëzore me një dashuri dhe drejtësi të vërtetë.

Jezusi na thotë të gjithëve:

“Ejani dhe më ndiqni!” (Gjn 21,19). Thirrja e Jezusit: “më ndiqni” lejon të dëgjohet në rrugë e mënyra të ndryshme, në të cilën ne shkojmë së bashku me nxënësit e Tij. Thirrja qëndron në shumës e jo në njëjës: “Lutuni, pra Zotërisë së të korrave, të dërgojë korrtarë në të korrat e veta” (Mt 9,38).

Martyria është pra dëshmia për fe. Kjo është konkretizuar përherë gjatë historisë së kishës nëpër shekuj. Filozofi atëist Friedrich Nietzsche thoshte dhe kërkonte një herë: “Të krishterët duhet të duken të shëlbuar, në qoftë se unë duhet të besoj në Shëlbuesin e tyre”. Në njëfarë mënyre edhe ka pas të drejtë, sepse ne duhet të jemi e të jetojmë si të shëlbuar prej vetë Jezu Krishtit, duke e shfaqur dinjitetin e krishterë.



1. LITURGJIA (greq.: λειτουργία leiturgia detyrë e hapur prej λειος leitos hapur, publike prej λαος laos popull dhe εργον ergon veprë, detyrë)

Liturgia nënkupton kremtimin e përkujtimin të mundimeve shpërblytare të Jezu Krishtit, të vdekjes, si edhe të ngjalljes së tij të madhëruarve e të ngjiturit të tij në qiell. Kremtimi eukaristik, që është kulmi i krejt liturgjisë, përkujtim kremtor i të vërtetës, kur buka dhe

tonë. Kisha katolike i ka shtatë sakramente: Pagëzimin, rrëfimin, kungimin, krezmimin, vajimin, urdrin e shenjtë dhe kurorën e martesës. Sakramentet janë akte të shenjta dhe burim shenjtërie. Sakramentet na afrojnë dhe na dhurojnë pranimë e Zotit dhe ato janë një festë e jetës që na dhuron Zoti në jetën tonë.

2. MARTYRIA: (Μαρτυριον - dëshmi, martyrein = të japësh

bashkësisë famullitare

3. DIAKONIA: (Διακονία, *diakonia*, *dia-dia* “nëpërmjet” dhe *κομία* “shtëpia” përkthim i lirë: “ekonomi shtëpiake”, me mirë: “shërbim, detyrë”. Nënkupton të gjitha shërbimet apo detyrat për njeriun në bashkësinë e kishës.)

E treta detyrë themelore në kishë është diakonia, detyrë dhe veprim për njerëzit që janë në nevojë, në mjerim, në të afërmit që kanë nevojë. Për Jezusin kjo detyrë është një dëshmi e drejtpërdrejtë për Atë, pra e lidhur ngushtë me personin e tij. “Për të vërtetë po ju them: çka do bëjë për njërin ndër këta vëllezërit e mi më të vogël, e bëtë për mua” (Mt 25,40b). Besëlidhja e Re gjithnjë na i paraqet kërkesat konkrete dhe na udhëzon në shërbim për të afërmit. Ungjilli shenjt sipas Mateut në kapitullin e 25, ku Jezusi edhe flet, na e paraqet “Gjyqin e fundit të mbarë botës”. Këtu paraqiten detyrat në shërbim të të afërmit sipas nevojave: të uriturit me i dhanë me ngrënë, të etshmit me pi, shtegtarin me përbujtë, të zhveshurin me e veshë, të sëmurin dhe të burgosurin me e vizitue (khs. Mt 25,41-46).

Këto janë kërkesa të dedikuara për njerëz. Vetë Jezusi tregon në predikimet e tij, se Mbretëria e qiellit është për të gjithë njerëzit, për të gjitha kategoritë sociale. Prandaj, të krishterët janë të ftuar me jetën e tyre, me fjalë ta shpallin Mbretërinë qiellore tek ata që janë të sëmurë, të ligshhtë... Detyra dhe shërbimi ndaj të afërmeve është një shenjë për të gjithë të krishterët, se si njeriu mund t’i shërbej Zotit duke i shërbyer njeriut, tjetrit.

Përveç “apostullatit”, pra dërgimi për shpalljen e ungjillit, Kisha që nga kohët e hershme e ka vënë detyrën e *xhakonit* (khs. Vap 6, 6). Kisha mundohet që këto kërkesa me veprimtarinë ndihmëse të jetë e pranishme në nevojat e popullit për të mirën e popullit, sikur që janë p.sh.: *Caritasi* e aktivitete tjera bamirëse.

4. KOINONIA: nga greqishtja *κοινωνία* - *koinonia*, bashkësi, shoqëri. Dërgimi dhe detyra e Kishës do të vërtetohet në mënyrë të drejtë pra botës, në

qoftë se ata, të cilët besojnë në Jezu Krishtin (pra të krishterët), jetojnë në bashkësi dhe si bashkësi.

Koinonia - *κοινωνία* ose edhe lat. *communio* thekson qartë se Kisha është e të gjithë atyre që janë të pagëzuar, dhe si të tillë, bashkërisht (*communio*) e përbëjnë atë. Në Konkilin II të Vatikanit janë veçuar disa struktura demokratike në kishë, të ashtuquajtura “*elemente synodale*” që janë ringjallur, si: Këshilli i famullisë, i kishës, i dekanatit, i ipeshkvisë.

Në këtë mënyrë dhe në këtë kuptim është e përputhur Fjala në Besëlidhjen së Re me Bashkim me Jezu Krishtin (1 Kor 1,9), me *Shpirtin Shenjt* (2 Kor 13,13), në *ungjill* (Fil 1,5), në *fë* (2 Ptr 1,4). Kjo bashkësi është e lidhur me Atin, me Birin dhe me Shpirtin Shenjt, si dhe me të gjithë të krishterët, të bashkuar me njëri-tjetrin, kudo që janë në botë. Bashkësia me Atin dhe me Birin, i përshatet Besëlidhjes së modelit të Jezusit për bashkimin e nxënëseve të Jezusit dhe qëndrimin të tyre në këtë bashkësi të pandashme (Gjn 17,21-23). Ky *communio* sipas Besëlidhjes së Re është i themeluar sakramentalisht.

Kjo bazë sakramentale e *communio* është bashkësia në një pagëzim të vetëm, sepse nëpërmes pagëzimit i takojnë një trupi të vetëm të Krishtit (1 Kor 12,13; Rom 12,4; Gal 3,26-28; Ef 4,3). Pagëzimi i përbashkët e argumenton pra *communio*-bashkimin fundamental të Kishës. Pikën e lartë të bashkimit na e mundëson “*communio* - bashkësia eucharistike”.

Në tekstin i Kor 10,16-18, gjejmë: “Gota e bekimit, të cilën ne e bekojmë, a nuk është bashkim me Gjyqin e Krishtit? Po edhe buka të cilën ne e ndajmë, a nuk është bashkim me Trupin e Krishtit? Pasi është një bukë e vetme, ne, edhe pse shumë, jemi një trup i vetëm: pse të gjithë jemi pjesëtarë të një buke”.

Jezu Krishti i ftoi apostujt rreth vetes në një rreth të ngushtë dhe e ngriti këtë bashkim me të gjithë dhe për të gjithë: “Kujtohen dy apo tre në emrin tim të bashkuar aty jam edhe unë në mesin e tyre”.



Etërit e Kishës

Justini i Romës, filozof dhe martir (100 – 165)

■ SHKRUAN:
Don Marjan DEMAJ



Justini u lind në fillim të shekullit II në Flavia Neapolis (sot Nablus, Sihemi i vjetër), në Samari, nga një familje me prejardhje romake. Justini ishte pagan. Fenë e krishterë e pranoi në moshë të pjekur.

Në kohën e tij filozofët në Romë kishin të drejta të mëdha qytetare dhe ishin të privilegjuar. Ashtu edhe Justini merr rrugën për në Romë dhe aty hap një shkollë filozofike. Në këtë mënyrë, sa më tepër që vinin njerëz nga bota greke, Roma pushtohej me kulturën helenistike dhe me religjione orientale. Panteoni mbushej me hyjni të ndryshme. Ndërkaq filozofët zgjonin kureshtje tek njerëzit.

Romakët kishin një specifikë: bashkonin hyjni të shumta, sikurse të pasurit që i grumbullojnë skulpturat e ndryshme anembanë botës. Kjo ishte praktikë romake. Historia u bë komike në Romë dhe për fat të keq kjo histori zhvillohej në kushtet e një herezie shumë të madhe. Mendimtarët e drejtë së shpejti ndiejnë lodhje në këto rrethana të jetës. Në vete ndiejnë zbrazëti dhe ashtu fillojnë të interesohen për gjëra të reja. Kështu, në këto rrethana, edhe feja e krishterë filloi të jetë mjaft tërheqëse. Fi-

lozofia, hap pas hapi e dalëngadalë, i afronte njerëzit kah pragu i fesë. Ashtu edhe Justini deri tek pragu i fesë arriti nëpërmes filozofisë.

Kur Justini kthehet në fenë e krishterë, krishterimi ishte në vlimin e plotë, sepse kishte profetë të rrejshëm, shkolla të ndryshme. Ato ishin bashkësi të vogla, por ishin shumë dhe në të gjitha këto vështirësi ishte të njihej Kisha e vërtetë e Krishtit.

Justini pati fat të kthehet në fenë e krishterë pikërisht atëherë kur ende ishin gjallë njerëzit, të cilët i kishin njohur Pjetrin e Palin, ndërsa në Efez takohej me ata që e kishin njohur dhe dëgjuar Gjonin. Justini, pra, ishte afër trungut, afër burimeve të pastra fetare, të krishtera.

Justini u martirizua në vitin 166. Përkujtimin e tij e festojmë më 1 qershor.

Veprat

Justini shkruan dy *Apologji*, të cilat janë mjaft të njohura. Njëra është ajo që ia drejton *Antoninit* dhe tjetra quhet *Dialogu me Trifonin*.

Këto dy vepra e reflektojnë organizimin e Kishës në atë kohë.

Apologjia e parë ishte shkruar rreth vitit 135 dhe ishte e përbërë prej dy pjesëve. Në pjesën e parë Justini kundërshtonte paganët për akuzat që ata ua bënin të krishterëve (kapitulli 1-12). Paganët thoshin se të krishterët janë ateistë, sepse nuk i nderojnë zotat e tyre, ndërsa Justini u përgjigjet: "Të krishterët vërtet nuk i nderojnë zotat që janë fantazmë e njerëzve, por kjo nuk do të thotë se janë ateistë, sepse ata e nderojnë Zotin e vërtetë."

Në pjesën e dytë autori sqaron përmbajtjen e mësimin të krishterë dhe dëshmon për besimin dhe hyjninë e Jezu Krishtit, përkatësisht se Jezu Krishti është Zot i vërtetë (kapitulli 30-53).

Për sakramentet e hyrjes në bashkësi të krishterë, shkruan në kapitujt 61-67. Ndërsa në kapitullin 68 thotë: *Që mos t'i dënojnë njerëzit e pafaj vetëm se janë të krishterë.*

Justini mendon se të krishterët dënohen vetëm e vetëm pse njerëzit nuk i njohin mirë. Po t'i njihnin mirë ata dhe fenë e

tyre, të krishterët nuk do të pësonin salvime dhe keqtrajttime të shumta deri edhe me vdekje. Ai i jep rëndësi mësimin mbi fenë, po edhe mbi traditën dhe Shkrimin e Shenjtë.

Apologjia e dytë është plotësim i së parës. Shkas i këtij shkrimi u bë Urbiku i Romës. Ky ishte prefekt i qytetit të Romës, i cili i gjykon për vdekje tre të krishterë vetëm e vetëm pse e dëshmojnë fenë.

Justini ia tërheq vërejtjen Urbikut për krimet që ua bënë të krishterëve. Ai thotë: *salvimi vjen nga demonët, të cilët e urrejnë të vërtetën. Kjo është veepër djallëzore.* Pjesa kryesore flet për rrymat kryesore filozofike siç janë stoicizmi dhe platonizmi. Justini e lartëson në këtë kon-

tekst krishterimin mbi të gjitha filozofitë e tilla.

Dialogu që bën me Trifonin hebre, është një veepër tjetër e Justinit me përmasa të gjera. Në këtë veepër ai polemizon me judenjtë. Judenjtë mendojnë se judaizmi është keqtrajtuar, ndërsa Justini thotë se judaizmi nuk është keqtrajtuar, por është i mangët me mospranimin e Jezu Krishtit si Mesi, të cilin e paralajmëruan profetët.

Justini në mësimet e veta dëshiron të zbërthejë të vërtetën, e cila mbron të krishterët. Flet për Logosin, por nuk e sqaron qartë sikurse e sqaroi Filoni. Justini thotë: *Logosi hyjnor u mishërua në Jezu Krishtin dhe na shpalli të vërtetën e plotë.* Më tutje shton se *çdo njeri si qenie racionale participon në një mënyrë në Logosin hyjnor, i cili ka në vetvete një pjesë të tij. Duke iu falënderuar këtij participimi, mund të arrijmë deri tek e vërteta.*

Për fund, mund të thuhet se të krishterët duhet ta dëshmojnë Zotin me jetë, ndërsa Kisha me singëritet për të bërë dialog me botën. Justini kërkonte që bota të jetë realiste ndaj Kishës, ta nderojë atë, sepse besimtarët e saj nuk janë më pak njerëz dhe, si të krishterë, edhe ata duhet të jenë të nderuar dhe të pranuar.



Jeta bashkëshortore në shekullin e komunikimit

Edhe te populli shqiptar gjithnjë e më shumë po ndjehet nevoja që t'i kushtojmë më shumë vëmendje çështjeve, siç janë familja, martesë, jeta bashkëshortore, roli i burrit dhe gruas në familje dhe shoqëri... Fenomeneve të tilla sapo mendojmë se u kemi dhënë hapësirë dhe kohë të mjaftueshme, shohim se kemi nevojë që për to të flasim edhe më shumë, të paktën tani në rrethana të reja, që dita ditës po ndryshojnë të përcjella me një ritëm zhvillimor teknik shumë të shpejtë. Kjo lë të kuptohet se jemi bërë më të vetëdijshëm se këtyre problemeve nuk mund t'u qasemi shkel e shko, por çështja familjare kërkon një trajtim serioz të përbashkët, duke filluar nga personat veç e veç, grupet e moshave të ndryshme e deri te shoqëria si e tillë – me institucionet e saja shtetërore. Hapin e parë që mund ta bëjë në këtë drejtim njeriu i këtij shekullit është: të fillojë të mësohet për të komunikuar.

■ SHKRUAN:
P. Shtjefën DODES SJ

Të mësosh të komunikosh – sfida dhe detyrë e jetës

Se sa e rëndësishme është që në rend të parë të perceptohet se sfida ekziston, që atë pastaj të mund ta shikojmë në sy, të reflektojmë mbi të, në mënyrë që të mund t'i bëjmë ballë asaj, tregon edhe dëshmia e psikoterapistit kroat me eksperiencë, Pavao Brajsa. Ai ndër të tjera shkruan: "Në praktikën time shumëvjeçare si psikoterapist i çifteve bashkëshortore, kam takuar një numër shumë të madh të raporteve bashkëshortore të paushqyera, të uritura dhe të vryshura, që, në fakt, janë martesë të vdekura vetëm se e kanë një fasadë formale të jashtme të institucionit martesor civil dhe kishtar." Dhe këshillon: "Për t'i ruajtur raportet bashkëshortore të gjalla dhe aktive, të kënaqshme për çiftet bashkëshortore, partnerët duhet patjetër të merren me to, të rezervojnë kohë për tu marrë me to dhe të sigurojnë hapësirë në të cilën rrethina nuk do t'i pengojë." Ekzistojnë një numër i madh burrash e grash që merren me gjithçka tjetër, por jo vetëm me raportin e tyre burrë-grua. Shumë çifte bashkëshortore nuk merren me komunikimin në mes tyre, nuk kanë kohë për të dhe nuk gjejnë vend në të cilin do të mund të merreshin papengueshëm me të. Brajsa vë në dukje shprehitë (e pavetëdijshme) të këtyre çifteve: "Merren me shtëpi, me kopsht, me kuzhinë, me fëmijë, me veturë, me vrapim, me notim, me sport, me shëndetin e tyre trupor edhe me aktivitete të panumërta shumë të vryshme, duke harruar këtu se të gjitha këto i përdorin brenda martesës, respektivisht, brenda marrëdhënieve bashkëshortore që, nëse lihen anash, me destruktivitetin e tyre dhe me potezat irracionale, i asgjësojnë dhe i bëjnë të hidhura rezultatet e shkëlqyeshme në të gjitha fushat tjera të martesës, familjes, si dhe çiftit bashkëshortor veç e veç."

Ekzistojnë edhe martesë që nuk ndahen, por mbesin, "të ruajtura", por "të vdekura", pa jetë, pa komunikime. Michael Lukas Moeller i përshkruan martesat e

tilla si jo të ardhura në vete, në të cilat çifti bashkëshortor nuk e kupton se i duhet t'i kthehet marrëdhënies së vet për ta mbajtur, se as që e ndjejnë që për të duhet bërë diçka. Ata "nuk e dijnë se nuk janë duke ditur" të kujdesohen për komunikimin, "marrë-dhënien" e tyre dhe ta mbajnë atë. Kur çiftet bëhen të vetëdijshme për çrregullimet në komunikim, në marrëdhënien e tyre, nuk dinë çfarë duhet të bëjnë që ta përmirësojnë. Nuk kanë shembull as përfytyrim, në mënyrë që të ketë mundësi të duket si komunikim i mirë. Si pasojë, kemi mungesën e komunikimit

minuta. Pa bisedim nuk mund të jetohej asnjë komunikim. Për konfliktet në komunikim duhet të bisedohet, kurse ndjenjat të ndahen me njëri-tjetrin. Psikoterapistët vënë në dukje se mërzia, zhgënjimi, nervozizmi shtypen dhe lajmërohen si simptoma. "Në komunikime të tilla nuk është e pranishme kënaqësia. Shkaktohet të çerotizuarit dhe të deseksualizuarit e marrëdhënieve bashkëshortore. Erotika humbet nën barrën e pezmatimit dhe rezignacionit (ikjes nga ballafaqimi/pakundërshtimit). Kënaqësia vjen duke u venitur. Çiftet gjithnjë e më pak duhen. Besimi në

munikimi i çiftit bashkëshortor është ushqimi elementar i marrëdhënies bashkëshortore. Pa të ajo thahet dhe vdes, humbet.

Çifti bashkëshortor vetiu e ka realitetin e tij të martesës së përbashkët. Këto dy realitete të martesës duhet të njihen, vazhdimisht të krahasohen dhe për to të komunikohet intensivisht. Nuk ka martesë pa konflikte të çifteve bashkëshortore dhe për këtë arsye është shumë me rëndësi aftësia e çiftit për t'u qasur atyre në komunikimin bashkëshortor. Është me rëndësi edhe si çift të drejtohes nga barazia ndaj vetvetes dhe ndaj partnerit

problematisë familjare bëjnë me dije se ka kaluar koha kur është mundur të mbahet një martesë përbrenda e vdekur në bazë të obligimeve, detyrave dhe opinionit publik. Sot e gjithë kjo pak nga pak po e humb fuqinë e vet të ndikimit në çiftin bashkëshortor.

Ndarja emocionale e martesës

Pak mendojmë dhe pak e marrim vesh se ekzistojnë dy ndarje të martesës. E para është formale, para gjyqtarit me letra zyrtare, kurse tjetra është me natyrë të brendshme, ajo emocionale, lidhore (përkatese), që nuk e shprehim para të tjerëve as para partnerit martesor dhe shpesh as para vetvetes. Kjo është prishje e heshtur, e brendshme e martesës me fasadë dhe formalitet të ruajtur të jashtme, madje edhe me obligime dhe detyra që rrjedhin nga kjo. Kjo është një martesë për fëmijë dhe fqinjë e flijuar për prindërit dhe familje, por pa një lidhje dhe kuptim të vërtetë të brendshëm, pa frymë dhe shpirt. Një martesë e tillë e vdekur atëherë mundohet të kapet pas një "të treti" përjashta ose lëshohet në një rutinë, shprehi, me një qëndrim të "sa më pak kundërshtim" dhe me një komoditet të brendshëm – "sa më shumë të më lënë rehat".

Ja edhe disa pyetje që psikoterapisti Brajsa që ia paraqet një çifti, i cili do të duhej t'ia bënte vetes: sa i përshatet ky përshkrim edhe martesës sonë? Sa minuta në ditë bisedojmë me partnerin tonë të martesës për çështjet thelbore dhe problemet e martesës sonë, jo vetëm të llogarive bankare, blerjes së veturës së re, ndreqjes së një shtëpie të vogël për pushime e gjëra të ngjashme, por për atë se çfarë po ngjan ndër në momentet më intime, si po e ndiejmë njëri-tjetrin në veten tonë, çfarë po përjetojmë në shtratin bashkëshortor, a jemi tashmë moti kohë brenda e në të vërtetë "të ndarë"?

Ndoshta për dikë do të jetë i fortë për t'u përbirë përfundimi real i psikoterapistit kur thotë: "Në shekullin 21 mund të mbi-jetojnë vetëm martesat cilësore dhe të kultivuara (të mbajturshme), kurse ato jo cilësore dhe jo të kultivuara nuk kanë shansë."



“Për t'i ruajtur marrëdhëniet bashkëshortore, lypset biseduar për çështjet thelbore të komunikimit/raportit të tyre, ta pranojnë realitetin e dyfishtë të partnerit në komunikim, mirëpo edhe barasvlefshmërinë e plotë në të. Biseda për komunikimin bashkëshortor është kusht pa të cilin ai nuk mund të qëndrojë. Komunikimi i çiftit bashkëshortor është ushqimi elementar i marrëdhënies bashkëshortore. Pa të ajo thahet dhe vdes, humbet.”

në komunikim. Kjo është venitje e çiftit brenda një çifti ekzistues që çon në zvogëlimin e bisedimit në komunikim. E zhvillojnë komunikimin bashkëshortor pa komunikim, që është më i rrezikshëm se sa ndarja e që mund të zgjatë me vite.

Disa të dhëna tregojnë se çiftet amerikane bisedojnë 4 minuta në ditë, kurse ato gjermane 2

dashurinë e madhe humbet.”

Për t'i ruajtur marrëdhëniet bashkëshortore, lypset biseduar për çështjet thelbore të komunikimit/raportit të tyre, ta pranojnë realitetin e dyfishtë të partnerit në komunikim, mirëpo edhe barasvlefshmërinë e plotë në të. Biseda për komunikimin bashkëshortor është kusht pa të cilin ai nuk mund të qëndrojë. Ko-

në komunikimin bashkëshortor si dhe ta pranosh lojën e pavetëdijshme të përbashkët në të.

Martesa në të cilën të gjitha të cekurat nuk përfillen, atëherë ato shtypen, shtyhen, lihen anash, në të cilat çifti martesor merret me të gjitha, vetëm jo me veten dhe komunikimin e tyre, me docmos vryshket dhe përfundon me ndarje joformale apo formale. Njohësit e



Papa Benedikti i XVI, pritë në aeroport nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara George Bush

3

Më 15 prill 2008, Papa Benedikti XVI, së bashku me sekretarin e shtetit kardinalin Bertone, me sekretarin personal, me stafin e tij të ngushtë dhe me shumë se gjashtëdhjetë gazetarë, u nis për një vizitë gjashtëditëshe në SHBA. Ky udhëtim është i teti me radhë në arenën ndërkombëtare. Papa ka arritur në aeroportin e Andrews Air Force Base në Washington në ora 16 (sipas orës vendase). Tek këmbët e shkallës së aeroplanit, Benedikti XVI ka pranuar mirëseardhjen personale të presidentit George W. Bush dhe të first Lady Laura. Vizita e Papës në shtetet e bashkuara të Amerikës zgjati deri më 21 prill. Gjashtë ditë këto shumë intensize: festimi i 81-vjetorit të lindjes, kremtimi i përvjetorit të tretë si pasardhës i shën Pjetrit, fjalimi në Shtëpinë e Bardhë, fjalimi në Asambelën e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, takimet e ndryshme me krerët e religjioneve, dhe me ata të konfesioneve tjera të krishterë, takimi me ipeshkvijtë, me meshtarë dhe regulltarë, me seminaristë dhe në fund mesha përfundimtare në Yankee Stadium të New York-ut.

Gjatë fluturimit prej Romës në Washington, Papa në përgjigjet e tij dhënë gazetarëve shprehu edhe qëllimet kryesore të kësaj vizite. Sipas Benediktit XVI, qëllimi i parë ishte vizita Kishës Amerikane, e cila kremtonte 200-vjetorin e ngritjes nga ipeshkvia në Kishë metropolit të ipeshkvisë së Baltimore dhe themelimin e katër ipeshkvive të reja: atë të New York-ut, Philadelphia, Boston e Louisville. Dhe në kuadër të këtij festimi Papa do të realizonte edhe takime ndërfaqetare dhe ekumenike. Qëllimi i dytë është festimi i 60-të vjetorit të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut. Shton Papa: "të drejtat e njeriut janë baza antropologjike, janë themelime të filozofisë së Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe themeli

njerëzor dhe shpirtëror, në të cilën është ndërtuar ky organizëm".

Përhëndetja e presidentit Bush drejtuar Papës dhe fjalimi i parë i Benediktit XVI-të në Shtëpinë e Bardhë në Washington

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fjalimin e tij përhëndetës, duke i uruar mirëseardhje kreut të Kishës Katolike, e cilësoi vizitën e tij si një nevojë jashtëzakonisht e madhe të popullit amerikan për porositë e tij që t'i rikujtojë këtij kombi modern mesazhin e shpresës, vlerën e jetës, porositë e dashurisë dhe të bashkëpunimit. Presidenti vlerësoi grishjen e Papës në luftimin e relativizmit dhe të një bote ku gabimisht mendohet se mund të jetohe vetëm, pa të tjerët. Në këtë mënyrë populli amerikan mund dhe duhet t'i kundërvihet egoizmit.

Papa Benedikti XVI shprehu mirënjohjet e tij të thella për mikëpritjen dhe në fjalimin që inicioi njëherit vizitën e tij, ai shprehu dashurinë e madhe ndaj popullit amerikan duke vënë në pah në rend të parë kërkimin e lirisë, gase kjo liri ka qenë e bazuar vazhdimisht nga bindja që, principet që e drejojnë jetën politike dhe morale, të jenë në përputhshmëri me ligjin e Hyjit, Zot dhe Krijues. Papa tha me tutje që vjen në Amerikë si mik, por edhe si predikatar, si apostull i ungjillit. Qysh në fillim të kësaj vizite Ai, grishi popullin amerikan që të luftojnë në mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të të gjithë qytetarëve. Ai theksoi edhe rolin e Kishës katolike dhe të fesë në zhvillimet e përgjithshme botërore: "Kisha nga ana e saj, dëshiron të ndërtojë një botë sa më të denjë për njeriun, i cili është i krijuar në përngjasimin e Hyjit (Khs. Zan 1, 26-27). Ajo është e bindur se feja shpërndanë një dritë mbi të gjitha gjërat dhe ungjilli është ai që e zbulon thirrjen dhe qëllimin kryesor të çdo njeriu (khs. Gaudium et Spes, nr. 10).

Feja me tutje na ofron fuqinë për t'u përgjigjur thirrjes sonë dhe na frymëzon që të operojmë sa më shumë për një shoqëri të drejtë dhe vëllazërore."

Takimi i Papës me ipeshkvijtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

(Kremtimi i mbrëmjesor në Shënjetorin e Zonjës së papërlhyer në Washington, më 16 prill 2008)

Një prej takimeve me rëndësi, ishte edhe takimi i Papës me të gjithë ipeshkvijtë e këtij vendi. Papa Benedikti XVI shprehu miqësinë dhe dashurinë e madhe që Kisha në Amerikë e ka pasur gjithnjë për zëvendësin e shën Pjetrit. Tani kjo vizitë dhe ky takim dëshiron të ripërtrijë edhe më shumë këtë respekt dhe këtë miqësi të ndërsjellë. Menjëherë në fjalimin e tij të drejtuar barinjëve të Kishës Amerikane, Papa vuri në dukje veçoritë pozitive që e dallojnë këtë popull: tokë e një feje të madhe, popull bujar, kërkues dhe mbështetës i lirisë e sidomos lirisë fetare, pranues i emigrantëve, popull që ruan dhe ndërton paqen në shumë vende të botës, popull i cili kujdesohet dhe ndihmon shumë popuj të varfër...etj. Prandaj në këtë kontekst, Papa ftoi ipeshkvijtë amerikanë që të mbjellin farën e ungjillit. Dhe kërkoi që qendra e shërbesës kishtarë duhet të jetë: "ndihma që duhet dhënë njerëzve për të ndërtuar dhe ushqyer vazhdimisht një raport vital me Krishtin-shpresën tonë". Papa u bëri ftesë ipeshkvijve në ruajtjen dhe në mbrojtjen e familjes dhe që familja të jetë në qendër të shoqërisë.

Një prej brengosjeve, dhimbjeve apo plagëve më të mëdha që mban Kisha amerikane, është abuzimi seksual ndaj të miturve. Prandaj, Papa fton ipeshkvijtë që sa më urgjentisht të përballohen me këtë problem jashtëzakonisht të madh dhe të gjejnë mënyra sa më adekuate për shërimin e kësaj dukurie shumë negative dhe që është kundërdëshmi i vetë mi-

"Christ


Vizita e Papës Benediktit XVI në (15-21 prill 2008)

Takimi i Papës me përfaqësuesit e religjioneve tjera në qendrën kulturore në Washington

Të emërtuar me emrin e Gjon Palit II

Në fillim të fjalimit të tij, Papa Benedikti XVI falënderoi të gjithë përfaqësuesit e religjioneve të ndryshme që kanë pranuar të zhvillojnë një takim dhe reflektim të përbashkët. Ai njëherit theksoi edhe të gjitha ato aktivitetet që i bashkojnë dhe e mundësojnë dia-

“ Kisha dëshiron të ndërtojë një botë sa më të denjë për njeriun, i cili është i krijuar në përngjasimin e Hyjit (khs. Zan 1, 26-27). Ajo është e bindur se feja shpërndanë një dritë mbi të gjitha gjërat dhe ungjilli është ai që e zbulon thirrjen dhe qëllimin kryesor të çdo njeriu (khs. Gaudium et Spes, nr. 10). Feja me tutje na ofron fuqinë për t'u përgjigjur thirrjes sonë dhe na frymëzon që të operojmë sa më shumë për një shoqëri të drejtë dhe vëllazërore. ”



Our hope"

ë Shtetet e Bashkuara të Amerikës

logun ndër-religjioz, siç është lutja e përbashkët në festën kombëtare të falënderimit, iniciativat e përbashkëta në aktivitetet e bamirësisë dhe shumë zëra të bashkëndara në çështjet publike. Këto dhe shumë iniciativa tjera shërbejnë për të promovuar kuptimin reciprok dhe për një bashkëpunim sa më të madh për të mirën e përbashkët. Ftesa e gjallë e papës që të mbrohen të drejtat dhe liria fetare, në mënyrë të posaçme mos të ketë diskriminime për asnjë bashkësi fetare apo për asnjë individ. Papa u takua edhe me përfaqësuesit e fesës hebreje, ku me rastin e festës së Pashkëve (Pesah), u drejtoi një porosi të posaçme.

Takimi me anëtarët e Asamblesë së Përgjithëshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Është hera e katërt në historinë botërore që Papa, kryebartari i Kishës Katolike, viziton dhe u drejtohet me fjalë rasti Organizatës së Kombeve të Bashkuara. I pari ishte Papa Pali VI në vitin 1965, datë kjo historike që u hap

rrugën edhe pasardhësve të tij. Ndërsa Papa Gjon Pali II e vizitoi këtë oraganizatë për dy herë me radhë, në vitin 1979 dhe në vitin 1995. Selia e Shenjtë është e pranishme prej 2 prill 1964 në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me statut të vëzhguesit permanent, pa të drejtë vote. Detyrë kjo që udhëhiqet nga nunci apostolik në OKB. Ishte ky një rast shumë më rëndësi dhe bëri një jehonë jashtzakonisht të fuqishme në mediat e shkruara edhe elektronike në mbarë botën. Pritja e Papes u bë në mënyrë shumë solemne dhe me një entuziazëm jashtzakonisht të madh nga ana e të gjithë anëtarëve të kësaj organizate. Ekspertët dhe komentatorët e shumë që përcollën me vemendje këtë takim, theksuan që Papa Benedikti XVI ka dëshiruar që fjalimi i tij të jetë vazhdimësi e fjalimeve të paraardhësve të tij. E të gjitha këto fjalime e kanë burimin në enciklikën e Papës Gjonit XXIII "Pacem in Terras", ku theksohet qartë që konfliktet nuk ndërpriten me intervenime lufte.

Në qendër të vëmendjes ishte vetë roli që kjo organizatë ka në mbrojtjen e të drejtave njerëzore ku patjetër duhet të përfshihen edhe të drejtat fetare. Papa theksoi që "ligji natyror është burim i të drejtave njerëzore të shkruara në çdo zemër dhe në çdo shoqëri". Më tej Papa vuri re edhe rrezikun në të cilën po shkon bota deri tek një kuptim relativist në të drejtat e njeriut: "jo vetëm të drejtat janë universale, por është edhe faktori njeri subjekt i këtyre të drejtave. Përveç këtyre argumenteve, në fjalimin e Papës u cekën edhe temat me interes botëror, si është multilateralizmi, tema e globalizimit, detyrimi i intervenimit në nevojat e ndryshme...etj. Prandaj ishte shumë e fuqishme grishja nga ana e Kreut të Kishës që Oraganizata e Kombeve të Bashkuar t'u ndihmojë të gjithëve për të dalë ngadhnjmtarë ndaj sfidave më të mëdha botërore.

Lutja në Ground Zero – New York

Një prej etapave më të rëndësishme të vizitës së Benediktit XVI, ishte edhe lutja në vendin ku pësuan tragjikisht, në atentatin e 11 shtatorit 2001, në Ground Zero të New York-ut. Për dallim prej vendeve dhe momenteve tjera të kësaj vizite, Papa në këtë vend nuk dëshiroi të mbajë asnjë fjalim, por me një lutje dëshiroi t'i kujtojë viktimat.

Vizita e Papës Benediktit XVI-të, në shtetet e bashkuara të Amerikës që zgjati prej 15 deri më 21 prill 2008 do të jetë një shtytje e thellë për ripërtitjen e Kishës amerikane, një nxitje për një bashkëpunim me të ngusht në mesë Selisë së Shenjtë dhe drejtuesve politik, një rritje e entuziazmit në vazhdimin e punës edhe me të suksesshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuar dhe një afrim-bashkëpunim për të mirën e përbashkët ndërmjet religjioneve në USA.

Ati i Shenjtë, Papa Benedikti XVI, lutet për viktimat e 11 shtatorit 2001 në New York



O Zot i pages, jepi pagën tënde kësaj bote plot dhunë -

Page në zemrat e të gjithë burrave e grave,

e paqe ndërmjet Kombeve të tokës!

Bëj t'i kthejnë hapat në udhën tënde të dashurisë,

ata që i kanë mend e zemër

të prishura nga urrejtja....

Ndihmona e ngushëllona,

përforcona në shpresë

e na jep urti e guxim

të punojmë pa u lodhur kurrë për një botë

ku mbretëron paqja e dashuria e

vërtetëndërmjet Kombeve e në zemrat

e të gjithëve!

(Lutja e Papa Benediktit XVI në Ground Zero)



Papa Benedikti XVI gjatë kremtimit të Meshës së shenjtë

Dr. Hajredin Kuqi në manifestimet "Ditët e don Mikelit", Stubëll e Epërme



Intervista me Dr. Hajredin Kuqin

Kushtetuta së Kosovës dhe të drejt

Populli shqiptar në Kosovë priti me dekada Kushtetutën. Sa i plotëson kjo Kushtetutë aspiratat e këtij populli?

H. Kuqi: Dua ta theksoj që ky popull po e nxjerr një kushtetutë në kuptimin jo vetëm emocional, por në kuptimin si akt juridiko-politik, dhe ndoshta kësaj radhe për herë të parë në historinë tonë njerëzit nuk i frikësohen nxjerrjes së kushtetutës, por ka qenë një lajm i mirë. Unë mendoj se kjo kushtetutë ka respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet sovran dhe të pavarur. Është një kushtetutë e pranuar në tërësi nga faktori vendor, e pranuar edhe nga komunitetet jo shumicë dhe njëkohësisht e pranuar edhe nga faktori ndërkombëtar. Pra, unë besoj që aspiratat e popullit tonë për shënjë që kemi pasur janë të sublimuara në këtë kushtetutë dhe tani në këtë kushtetutë Kosova e ka shtetin e vet sovran dhe të pavarur, i ka të gjitha institucionet që i takojnë një shteti, ka një shtet modern demokratik dhe funksional.

Pas pavarësisht jemi në etapën e integrimi. A është kjo kushtetutë e përgatitur për integrim euro-atlantike?

H. Kuqi: Kushtetuta është e ndërtuar në tërësi, apo në përputhje me proceset e integrimi euro-

“ Ne kemi dhënë mundësinë që Kosova të quhet shtet laik në kuptimin e ndarjes së shtetit nga religjionet, por në kuptimin e zhvillimit të religjionit, unë mendoj që është kushtetutë shumë e avancuar dhe besoj që këtu mundësia e zhvillimit, në radhë të parë, mundësia e lirisë së besimit fetar, mundësia e bashkimit në bashkësitë fetare dhe mundësia e zhvillimit të bashkësive fetare në përputhje me rregullat e veta, garantohet me kushtetutë. ”

atlantike. Ne kemi dhënë mundësi që Kosova si subjekt ndërkombëtar të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare, por edhe të hyjë në marrëdhënie ndërkombëtare, në mekanizmat dhe nismat e ndryshme ndërkombëtare. Kushtetuta krijon mundësi të plota, plotëson kriteret që kërkohen në kuptimin juridik formal dhe është kushtetuta më moderne në rajon. Gjithsesi është një prej kushtetutave moderne në Evropë.

Aty edhe flitet që është një përgatitje për këto integritime...?

H. Kuqi: Kushtetuta ka krijuar mundësinë legale, ka krijuar mundësinë që Kuvendi i Kosovës, respektivisht institucionet e Kosovës të aplikojnë, pra jep mundësinë për një gjë të tillë, ndër-

sa procesi i anëtarësimit kërkon procesin e harmonizimit edhe juridik edhe politik edhe ekonomik. Në kuptimin juridik mendoj se kushtetuta është një bazë e mirë, edhe ligjet që po nxirren. Por në kuptimin ekonomik ne duhet të bëjmë përparime më shumë, ndërsa në kuptimin politik duhet të kemi stabilitet politik, zhvillim të demokracisë por edhe integritet të minoriteteve.

Me kushtetutë Kosova është shtet laik, disa e keqkuptojnë dhe mendojnë se është shtet ateist, ashtu lexohet, shkruhet. Çfarë obligime ka shteti i Kosovës ndaj bashkësive fetare?

H. Kuqi: Ne kemi pasur debate paraprake edhe me bashkësitë fetare në Kosovë dhe mund

të themi që në ato debate kemi arritur një konsensus të plotë për çështjet që janë theksuar. Ne kemi treguar neutralitet sa i përket besimeve fetare. Ne nuk e mohojmë besimin fetar, përkundrazi, garantojmë lirinë e besimit me kushtetutën e Kosovës bashkësitë fetare që janë në Kosovë, garantojmë të drejtat e tyre dhe garantojmë mundësinë e tyre që të zhvillohen në përputhje me rregullat interne që i kanë. Ne kemi dhënë mundësinë që Kosova të quhet shtet laik në kuptimin e ndarjes së shtetit nga religjionet, por në kuptimin e zhvillimit të religjionit, unë mendoj që është kushtetutë shumë e avancuar dhe besoj që këtu mundësia e zhvillimit, në radhë të parë, mundësia e lirisë së besimit fetar, mundësia e bashkimit në bashkësitë fetare dhe mundësia e zhvillimit të bashkësive fetare në përputhje me rregullat e veta, garantohet me kushtetutë.

Kisha katolike ka pasur vërejtjet e veta lidhur me nenin 25 e 26 ku flitet për të drejtën e jetës dhe integritetin personal, si dhe në nenin 37, e drejta e martesës dhe familjes. Sa janë marrë parasysh këto vërejtje në projekt-kushtetutë e tani në kushtetutën e Kosovës?

H. Kuqi: Dua ta them, me kënaqësi kam vërejtur që Kisha kato-

like e Kosovës, respektivisht edhe ipeshkvi kanë bërë një analizë të kushtetutës. Kam pasur takime dy herë, së bashku edhe me kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin Manaj, pastaj kemi pasur një debat me komisionin kushtetues së bashku me ipeshkvin e Kosovës, dhe kemi diskutuar për pikat veç e veç. Dhe mund të them që kemi arritur një kompromis të mirë, të pranueshëm për Kishën katolike dhe të pranueshëm edhe për komisionin kushtetues. Po e zëmë, te rasti i lindjes, të personit që ka të bëjë edhe me të drejtën për abort, ne kemi vendosur një dispozitë që thuhet: jeta është e paprekshme. Kjo i ngjan dispozitës 100% çfarë është në Slloveni dhe në këtë drejtim ne kemi arritur një kompromis, dhe pastaj me ligj do të përcaktohet, kur fillon jeta. Në anën tjetër, për sa i përket (që është bërë një keqkuptim), kushtetuta martesën e përcakton siç është e drejtë me ligj. Ligji është ai që e përcakton, në mes kujt dhe si do të jetë. Pra, në asnjë moment kushtetuta nuk e përmend martesën mes gjinive të njëjta. Dhe këtu do të ishte një absurd, ose ka qenë një keqkuptim. Dhe po ashtu besoj që, edhe për sa i përket pozitës së familjes e të tjera, ne kemi pasur debate të mira. Mund të them që kemi gjetur zgjidhje kompromisi, dhe në debate që kemi pasur me ipeshkvin e Kosovës dhe me stafin e tij, mendoj që kemi arritur

e Republikës garanton lirinë tën e besimit

“ Populli i Kosovës po e nxjerr një kushtetutë në kuptimin jo vetëm emocional, por në kuptimin si akt juridiko-politik, dhe ndoshta kësaj radhe për herë të parë në historinë tonë njerëzit nuk i frikësohen nxjerrjes së kushtetutës.

Unë besoj që aspiratat e popullit tonë për shënjë që kemi pasur janë të sublimuara në këtë kushtetutë dhe tani në këtë kushtetutë Kosova e ka shtetin e vet sovran dhe të pavarur, i ka të gjitha institucionet që i takojnë një shteti, dhe ka një shtet modern demokratik dhe funksional. ”

një kompromis, i cili i ka kënaqur edhe kërkesat e Kishës katolike, por edhe në anën tjetër të komisionit kushtetues. Pra, kemi pasur debat të mirë, shumë profesional, dhe do të them, debat, i cili ka respektuar vullnetet e dyanshme.

A e dëmton Pakoja e Ahtisarit kushtetutën e Kosovës?

H. Kuqi: Ne kemi qenë të kujdesshëm që të bashkojmë vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet sovran dhe të pavarur dhe të respektojmë zotimet e Kosovës përballë bashkësisë ndërkombëtare, që nënkupton Kosova ka marrë obligim për respektimin e

pakos së presidentit Ahtisari. Tri gjëra nuk kemi lejuar t'i pengojë pakoja. E para, që Kosova të jetë shtet sovran dhe i pavarur, e dyta, që Kosova ta shtrijë autoritetin e vet në tërë territorin e saj, dhe e treta, që të ketë institucionet penale në të gjitha nivelet, nga niveli qendror dhe ato lokal, dhe të ketë hierarki të plotë. Këto të tria i kemi arritur dhe sot Pakoja e Ahtisarit avancohet në drejtat e komuniteteve në Kosovë, por nuk e dëmton të drejtat e shumicës dhe nuk i bën jofunksionale institucionet e Kosovës. Por duhet ta kemi të qartë, bazën juridike, vullnetin e qytetarëve dhe për të cilin, Pakon

e Ahtisarit, janë vullneti jashtë komisionit kushtetues që janë përcaktuar. Por besoj që e kemi realizuar me sukses. Dhe dua ta them shumë qartë, që nuk po theksohet, në nenin 3, është e vërtetë që Kosova përcaktohet shoqëri shumë etnike, jo shtet shumë etnik. Pra, aty thuhet, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera. E kemi definuar qartë kush është në një mënyrë shumicë në Kosovë, dhe

me këtë ndoshta e kemi (për herë të parë po e them) e kemi tërhequr termin 'kosovar'. Nëse thuhet se në Kosovë jetojnë shqiptarët dhe komunitetet tjera, d.t.th. termi kosovar mund të hiqet dhe është ruajtur identiteti kombëtar.

Të tjerët na quajnë 'kosovarë'?

H. Kuqi: Nocioni kosovar ka qenë term më shumë geografik,

në momente të caktuara si shënjë e identitetit tonë për të krijuar shtetin dhe ne jemi identifikuar si kosovarë. Por unë mendoj se kjo ka qenë e arsyeshme si identitet deri në momentin kur e kemi fituar pavarësinë e Kosovës. Tani besoj që është e qartë dhe tani edhe me dashtë, kushtetuta e përcakton çka jemi ne.

Intervistoi:
P. Ndue KAJTAZI, O.F.M.

Curriculum vitae

Dr. Hajredin Kuqi është i lindur në Pejë me 2 janar 1971, studimet për drejtësi i ka mbaruar në Prishtinë, ka magjistruar në Ankara të Turqisë, kurse doktoraturën për drejtësi në Graz të Austrisë. I komplettoi studimet në fushën e drejtësisë në Washington, Gjenëvë e Berlin.

Është profesor në Universitetin e Prishtinës, nënkryetar i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ishte kryetar i komisionit për hartimin e Kushtetutës së Kosovës.

Kohë më parë Parlamenti i Republikës së Kosovës e aprovoj Kushtetutën, ajo pritet të hyn në fuqi në qershor të këtij viti.

Zoti Kuqi shprehet se i është bërë një nder i veçantë që ai të jetë hartuesi kryesor dhe kryetar i komisionit kushtetues. Kaq i ri në moshë, me këtë përgjegjësi të madhe, shumë vital dhe energjik, gjithmonë në vrap si një atlet për t'ia vënë themelet shtetit të ri.



Dr. Hajredin Kuqi, Zv/kryeministër i Republikës së Kosovës

Shqiptarët katolikë në/dhe Konkordatet – të Vatikanit

■ SHKRUAN:
Zef AHMETI

I. Rreth lëndës

Shqiptarët e besimit katolik gjatë historisë kanë qenë të lidhur ngushtë me disa procese historike dhe akte diplomatike gjatë kohës së përandorisë së Austrohungarisë, ku ata merren nën protektorat (mbrojtje) dhe më pastaj edhe nga disa akte diplomatike të shtetit të Vatikanit. Në këtu do shqeltojmë në mënyrë më të veçantë Konkordatet e Vatikanit dhe Jugosllavisë, përkatësisht pozicionin e Kishës Katolike në Kosovë.

Rreth kësaj teme është shkruar nga disa autorë shqiptarë dhe të huaj, mirëpo kjo është trajtuar në kuadër të studimeve tjera dhe tema *konkordatet dhe shqiptarët* ka qenë vetëm e prekur si element i patejkalueshëm historik, ndërsa nuk është studiuar në mënyrë të veçantë, por edhe nëse është shkruar për konkordatat është shkruar vetëm për periudha të caktuara.

Këtu kemi për qëllim që të japim një pasqyrë të përgjithshme rreth vetë konceptit të konkordatit, si dhe a janë trajtuar shqiptarët në këto konkordate.

II. Protektorati austrohungarez i shqiptarëve katolikë në Ballkan

Invasioni osman në Ballkan nënshtrioi edhe tokat shqiptare. Popullata e katolike shqiptare, e cila kërcënohej të konvertohet e gjitha në islam, e shtyn Perandorinë e Austrohungarisë që të marrë një hap diplomatik për t'i marrë në mbrojtje këta besimtarë të rrezikuar. Austrohungaria kishte bërë disa marrëveshje me Perandorinë Osmane për të marrë në mbrojtje katolikët në ato vende ku sundonin turqit, pra arrihen marrëveshjet e ashtuquajtura paqësore mes këtyre dy fuqive të asaj kohe, ajo e Vjenës në vitin 1615, 1681 në Stamboll, 1699 në Sremski Karlovac, në vitin 1718 në Pozharevc, më 1739 në Beograd dhe më 1791 në Svishtovë. Këto marrëveshje i mundësonte Austrisë që të intervenojë dhe mbrojtje katolikët në aspektin fetaro-kulturor. Këtu hynin edhe shqiptarët. Si figurë e njohur që ka dhënë një kontribut të çmuar në këtë drejtim, ishte edhe ipeshkvi i Shkodrës, Imzot Benino Alberini, i cili kishte kontakte të përhershme me Romën dhe Vjenën. Ndërsa në vitin 1837 zyrtarisht edhe Vatikanit ia bart kom-

petencat me dekret Austrisë që t'i mbrojtje katolikët në Ballkan. Austrohungaria në bazë të marrëveshjeve dërgon në Shqipëri misionarë dhe hap shkollë katolike dhe ndan subvencione dhe ndihma tjera për ta ndihmuar edhe ngritjen dhe mirëmbajtjen e objekteve fetare katolike. Kjo ndihmoi që populli shqiptar të zhvillohet dhe sado kudo të konstituohet. Me rënien e Perandorisë Austriake dobësohet edhe pozicioni i shqiptarëve katolikë, kështu që Vatikanit dërgon vizitatorin e vet, Ernesto Cozzi, për të parë gjendjen e Kishës Katolike në Shqipëri. Përveç nevojave të ndryshme dhe parregullsive, vizitatori Cozzi i raporton Vatikanit se një rrezik tjetër shumë i theksuar ishte ai jugosllav.

III. Vatikanit, konkordatet dhe marrëveshjet kishtare

a) Shteti i Vatikanit

Vatikanit ngrihet në kodrën e quajtur *mons vaticanus*, ku prej shek. II gjendet varri i Shën Pjetrit. Nga Konstatini I, i Madi, në këtë vend është ndërtuar bazilika e Shën Pjetrit. Në pjesën veriore me ndërtimin e Rezidencës Papnore (shek. 15.) bëhet

edhe qendra kryesore e administratës së Kurisë romake.

Pas okupimit të Romës nga trupat e Mbretërisë Italiane në vitin 1871, ajo bëhet pjesë e saj. Roma bëhet kryeqytet i Mbretërisë Italiane dhe kështu fillojnë ndërtimet e reja rreth qendrës së Vatikanit. Me okupimin e Romës dhe Vatikanit nga trupat e Mbretërisë Italiane, Papa shpallet si i «burgosur». Pas një kohe konfliktesh, çështja e Vatikanit në vitin 1929 zgjidhet me një marrëveshje, në bazë të së cilës krijohet shteti i qytetit të Vatikanit (*Stato della Città del Vaticano*) si shtet më i vogël në botë (0, 44 km²). Ky shtet i ri i Vatikanit nuk e zëvendëson Shtetin-Kishë (*Kirchenstaat*) të shuar në vitin 1871, por krijohet si subjekt i ri.

Vatikanit përbëhet kryesisht prej Bazilikës së Shën Pjetrit së bashku me sheshin, pallatet dhe kopshtet e Vatikanit, pastaj bazilikat patriarkale që shtrihen në qytetin dhe rrethinën e Romës, objekti i administratës së Kurisë romake, së bashku me rezidencën verore të Papës ku të gjitha këto gëzojnë privilegjin e ekstrritorialitetit.

Forma e shtetit të Vatikanit është e llojit të monarkisë, ku

Papa është ai që udhëheq ligjdhënësinë, jurisprudentin (drejtësinë), dhe kompetencat për të zbatuar ligjin. Sheti i Vatikanit është në shërbim të detyrave të Papës, përkatësisht të Selisë së Shenjtë në të drejtën ndërkombëtare, ai përbën sovranitetin shpirtëror e shtetëror të Papës. Si shtet sovran, Vatikanit ka po ashtu edhe organet e veta. Vatikanit ka flamurin e vet me ngjyrën e verdhë dhe të bardhë me çelësa të kryqëzuar, ka stemën, himnin, postën. Rajoni i Vatikanit është neutral dhe i pacenueshëm që gëzon mbrojtje edhe nga Konventa e Hagës për mbrojtje të pasurive kulturore. Me statusin e shtetit Vatikanit bëhet pjesë e së drejtës ndërkombëtare dhe me këtë Kisha Katolike bëhet feja e vetme në botë që ka mundësi të lidhë marrëveshje me karakter të së drejtës ndërkombëtare publike.

b) Konkordatet dhe marrëveshjet kishtare

b.1. Koncepti i Konkordatit

Konkordatet (*Concordatum*, *Convencion solemnis*) janë marrëveshje mes Selisë së Shenjtë si reprezentues të Kishës Kato-

“ Konkordatet (Concordatum, Convencion solemnis) janë marrëveshje mes Selisë së Shenjtë si reprezentues të Kishës Katolike dhe pushteteve shtetërore (shteteve apo institucioneve). Materie kryesore të Konkordateve janë kryesisht këto fusha: garancia e lirisë së fesë dhe asaj kishtare, edukimi, çështjet juridike të sakramentit të kurorës dhe çështjet finansiare. Konkordatet janë marrëveshje të dyanshme. ”



Bazilika e Shën Pjetrit në Romë

marrëveshjet diplomatike – me Jugosllavinë (I)

like dhe pushteteve shtetërore (shteteve apo institucioneve). Materie kryesore të Konkordateve janë kryesisht këto fusha: *garancia e lirisë së fesë dhe asaj kishtare, edukimi, çështjet juridike të sakramentit të kurorës dhe çështjet financiare*. Konkordatet janë marrëveshje të dyanshme.

b.2. Historia e Konkordatit

Si fillim i historisë së Konkordatit vlerësohet marrëveshja e lidhur mes Papës Calixus II dhe Heinrichit II në vitin 1121. Pika tjera të rëndësishme historike janë po ashtu edhe «concordata» e Papës Martinut V në vitin 1447 që lidhë me «kombet» e ndryshme. Një epokë e re e konkordateve fillon me ndryshimet që e kaplojnë Evropën pas Revolucionit Francez.

Pas Revolucionit Francez e deri në shel. XX lidhen konkordate me shumë shtete; Papa Piu II lidh konkordat me Napoleonin I në vitin 1801, Konkordatet mes Selisë së Shenjtë dhe Landeve Gjermane, me Austriën, Italinë, Spanjën, Portugalinë, me disa shtete të Amerikës Qendrore dhe Jugore, deri me Serbinë në 1914.

Pas Kodeksit të ri *Codex Iuris Canonici (CIC)* të vitit 1917, fillon një zhvillim i ri dhe intensiv i konkordateve që lidhen me shtetet e ndryshme si Polonia, Rumania, Çekosllovakia etj. Pastaj edhe vetë marrëveshja e krijimit të Shtetit të Vatikanit e vitit 1929 i jep një kahje të re marrëveshjeve të Konkordat.

b.3. Natyra juridike e Konkordatit

Për sa i përket natyrës juridike të konkordatit, ka disa mendime të ndryshme. Duke u bazuar në qëndrimet dhe pozicionin e Kishës Katolike konkordati është padyshim marrëveshje ndërkombëtare që hyn në familjen e marrëveshjeve ndërkombëtare publike. Të këtij mendimi janë edhe shumë juristë. Ndërsa këtë e konteston me dyshimin e tyre një grup tjetër që mendojnë se në karakterin ndërkombëtar të konkordatit do dyshuar për arsye se Selia e Shenjtë nuk posedon mundësinë e sanksionimit që kanë marrëveshjet

tjera ndërkombëtare, porse ajo mbështetjen e vetme e ka në besimin e ndërsjellë (*pacta sunt servanda*). Konkordatet vlerësohen po ashtu edhe si *quasi-marrëveshje* ndërkombëtare apo edhe si marrëveshje të karakterit *sui generis*, pra të llojit të veçantë.

Përveç karakterit juridik të konkordatit ne dallojmë po ashtu edhe disa lloje të konkordatit:

a) *Concordata pacis*- konkordatet e paqes, që njëkohësisht janë edhe marrëveshje paqeje mes shtetit dhe Kishës, si marrëveshje tipike e këtij lloji është ajo mes Papës Calixus II dhe Heinrich të V;

b) *Concordata amicitiae* apo konkordatet miqësore që kanë karakter të theksimit të kësaj miqësie, dhe

c) *Concordata defensionis iurium et libertatis Ecclesiae*, konkordati defenziv/mbrojtës, ka të bëjë p.sh. me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të Kishës me një shtet ku rrezikohet prishja e marrëdhënieve, por edhe me një ndryshim të një marrëveshjeje ekzistuese.

b.4. Marrëveshjet kishtare

Për dallim nga Konkordati, Marrëveshjet Kishtare nuk kanë karakter ndërkombëtar. Këto

marrëveshje kanë karakter të natyrës nacionale, pra është një marrëveshje mes Kishës Katolike në një shtet me organet shtetërore ku ajo vepron.

IV. Konkordatet para Luftës së Parë Botërore në Evropën Juglindore

Para Luftës së Parë Botërore konkordatet e lidhura me rajonin e Evropës Juglindore njihen ato me Perandorinë Austriake, Malin e Zi, me Perandorinë Austriake për Bosnën dhe Hercegovinën dhe konkordati me Serbinë. Ne nuk do të ndalemi në shtjellimin e konkordateve të shteteve

të Evropës Juglindore veç e veç, por vetëm të ai mes Vatikanit dhe Serbisë, në territorin e të cilit ishin edhe katolikët shqiptarë dhe katolikë të kombeve të tjera.

Konkordati mes Vatikanit dhe Serbisë nënshkruhet me 24. 06. 1914 në Romë. Rruga e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje natyrisht se nuk ishte e lehtë, por ka kërkuar bisedime intensive që në shtetin e ri të Serbisë t'iu sigurohen të drejtat e besimtarëve katolikë. Kisha Ortodokse Serbe që konsiderohej besim shtetëror, shumë pak tregonte tolerancë përballë lirisë së besimeve tjera. Meqë në atë kohë flitet që numri i besimtarëve katolikë ishte i vogël, ku padyshim hynin edhe shqiptarët, edhe pse kjo në literaturë flitet për «*djelmoshat serbe*» që dëshironin të bëheshin priftërinj katolikë(!), Vatikanin emëron vetëm një administrator apostolik me 09. 09. 1853 e ky ishte ipeshkvi i Gjakovos së Kroacisë, Strosmaieri (Strosmaier). Për besimtarët katolikë të dioqezës Shkup-Prizren ishte paraparë që të ndërtohet edhe një seminar për kualifikim shkollor. Qeveria e atëhershme serbe kishte kërkuar po ashtu që në liturgjitë në dioqezat katolike të përdoret «*gjuha e vjetër slave*». Mirëpo Selia e Shenjtë një kërkesë të tillë e refuzon, duke u mbështetur në faktin se kisha dhe famullitë të klasifikohen si *latine* dhe jo *glagolike*, pra sipas gjuhës me të cilën shërbehen me liturgji popullsia vendase. Qëllimi i Serbisë që të nënshkruajë konkordatin ishte më tepër akt politik që në arenën ndërkombëtare, përkatësisht në Evropë të tregohet se si në territorin e saj ekziston «toleranca» në besim. Gjatë gjithë procesit të përgatitjeve të konkordatit Kisha Ortodokse Serbe kishte qëndrim kundër. Mospërputhjet mes Kishës Ortodokse dhe asaj Katolike në politikat ditore ishte në atë shkallë e keqësuar sa që qeveria e Pashiqit në vitin 1891 i ndalon aktivitetet misionare të Kishës Katolike në territorin e Serbisë. Pas përfundimit të luftërave në Ballkan, fillojnë përsëri bisedimet dhe kështu edhe nënshkruhet konkordati. (vazhdon)

“ Konkordati mes Vatikanit dhe Serbisë nënshkruhet me 24. 06. 1914 në Romë. Rruga e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje natyrisht se nuk ishte e lehtë, por ka kërkuar bisedime intensive që në shtetin e ri të Serbisë t'iu sigurohen të drejtat e besimtarëve katolikë. Sepse Kisha Ortodokse Serbe që konsiderohej besim shtetëror, shumë pak tregonte tolerancë përballë lirisë së besimeve tjera. ”



Katedralja e "Zojës Ndhimëtare" në Prizren

Vështrim

KARL POPPERI

figurë komplekse e filozofisë moderne (I)

■ SHKRUAN:
Sare GJERGJI

Vepra e Popperit paraqet një filozofi sistematike në qendër të traditës së madhe të fushës studimore (Brajan Megi). Si e tillë, ajo nuk është një veprë thjesht mësimore. Popperi, siç do të shprehej Levinsoni, ka njohuri të thella dhe të hollësishme lidhur me shumë fusha të të menduarit, prandaj në faqet e veprës popperiane patjetër që do të ndeshemi me shumë autorë (duke filluar me parasokratikët e deri tek autorët bashkëkohanikë të tij), me shkolla e rryma mendimi, me teori e metoda nga më të ndryshmet për shumë fusha të dijes e të shkencës. Duke shqyrtuar probleme nga fusha të ndryshme, si nga teoria e njohjes, filozofia e shkencës, metafizika e filozofia shoqërore, Popperi do të shfaqë pikëpamjet e tij për racionalizmin e dijen përgjithësisht, për induksionin e demarkacionin, për metodën shkencore e falsifikacionizmin, për qëllimin e shkencës e rritjen e dijes shkencore, për epistemologjinë (të cilën Popperi e quan teori e njohjes shkencore), për gjuhën e botën 3, për metafizikën e realizmin, për historizmin e shumë çështje të tjera. Prandaj, në faqet e librit të tij do të ndeshen Talesi, Anaksimandri, Ksenofoni, Platoni, Aristoteli, Hume, Ruselli, Pauli, Tarski, Frege, Locke, Berkeley, Hegeli, Kepleri, Koperniku, Bohri, Descartes, Spinoza, Leibnizi, Kanti, Bergsoni, Friesi, Galilei, Darvini, Njutni, Einstein, Wittgensteini e shumë të tjerë.

1. Teoria tradicionale dhe teoria e Popperit


1.1. S'do mend se përpjekjet e racës njerëzore (mendojmë në njerëz të filozofisë, të shkencës, të dijes në përgjithësi) për ta kërkuar të vërtetën dhe për ta gjetur atë, nuk kanë munguar. Dhe natyrisht, këto përpjekje nuk janë përfundimtare, por janë gjithnjë të hapura dhe në mundësi për t'u korrigjuar e për t'u përmirësuar vazhdimisht.

Popperi, siç e vë në dukje

D. Miller, e vë theksin mbi hamendjet si rrugë nëpërmjet të cilave rritet dija dhe mbi kritikën, si mënyra nëpërmjet së cilës ajo kontrollon. Popperi vetë e përshtoi dijen, duke thënë se ajo zhvillohet nëpërmjet një vargu hipotezash dhe hedhesh poshtë të zgjidhjeve tentative të problemeve, të kontrolluara pa lëshim nëpërmjet testeve të rrepta. Pra, ai është i mendimit se dija jonë, doktrina jonë, është hipotetike (karakterin hipotetik të dijes njerëzore, Popperi e sheh që tek parasokratikët), se ajo përbëhet nga hamendjet, nga hipotezat, më shumë sesa nga të vërtetat e sigurta dhe përfundimtare dhe se kritika dhe shqyrtimi kritik janë të vetmet mjete tonat për t'u afëruar të vërtetës. Kjo, gjithnjë, sipas Popperit, të çon në traditën e hipotezave të guximshme dhe të kritikës së lirë (Popperi shpreh mendimin se qëndrimi kritik ndaj një doktrine nis që në shkollën joniane, me Talesin e Anaksimandrin), traditë e cila krijoi qëndrimin racional ose shkenstomologjinë (të cilën Popperi e quan teori e njohjes shkencore), për gjuhën e botën 3, për metafizikën e realizmin, për historizmin e shumë çështje të tjera. Prandaj, në faqet e librit të tij do të ndeshen Talesi, Anaksimandri, Ksenofoni, Platoni, Aristoteli, Hume, Ruselli, Pauli, Tarski, Frege, Locke, Berkeley, Hegeli, Kepleri, Koperniku, Bohri, Descartes, Spinoza, Leibnizi, Kanti, Bergsoni, Friesi, Galilei, Darvini, Njutni, Einstein, Wittgensteini e shumë të tjerë.

ri tjetër alternative, meqë ofron parashikime më të shumta e më të sakta, por që nesër edhe ajo mund të tejkalohet). Në të vërtetë, çdo zbulim shtrën, hap para nesh dilema e probleme të reja. Dhe më tej, në këtë traditë jo vetëm që janë të lejueshme, por risitë madje edhe nxitën dhe shihen si suksese.

“Popperi vërejti se tradita racionaliste, tradita e shqyrtimit kritik, përfaqëson të vetmen mënyrë praktike të zgjerimit të dijes sonë, të dijes së hamendësuar, ose hipotetike, çka lë të kuptohet se një teori, çfarëdo qoftë ajo, nuk mund të konsiderohet assesi si një e vërtetë përfundimtare, sepse gjithnjë ekziston mundësia e zëvendësimit të saj nga një teori më e mirë.”



Karl Popperi

1.2. Padyshim, që vëzhgimet dhe eksperimentet luajnë një rol të rëndësishëm (rolin e argumenteve kritike, bashkë me argumentet që nuk mbështeten te vëzhgimi) në zhvillimin e shkencës, por rëndësia e tyre varret tërësisht nga çështja nëse ato mund të përdoren apo jo për të kritikuar teoritë. Kështu, sipas

teorisë së njohjes, sipas Popperit, ka vetëm dy mënyra kryesore nëpërmjet të cilave dija teori mund të kenë epërsi ndaj të tjerave: ato mund të shpjegojnë më shumë gjëra dhe mund të testohen më mirë, d.m.th. mund të trajtohen në mënyrë më të plotë e më kritike... nën dritën e testeve vëzhguese ose

1.3. Sipas racionalizmit kritik (Popperi dallon racionalizmin kritik dhe racionalizmin jo-kritik ose përgjithësues, S.Gj.), siç heton D. Miller, argumentet janë gjithnjë negative, ato janë gjithnjë argumente kritike që përdoren dhe janë të nevojshme vetëm për të përjashtuar hipotezat e supozuara më parë. Prej këtyrë këndvështrimi, vazhdon më tej ky studiues, rrjedhin disa teza të tjera që janë në qendër të filozofisë së Popperit, si: hipotezat tona duhet të jenë të kritikueshme... sepse argumenti kritik është kontrolli i vetëm që ushtron mbi mendimet tona; dija jonë shkencore... zhvillohet nën tryshninë e kritikës së pareshtur; ... indeteterminizmi po aq sa realizmi dhe objektivizmi, është një kusht i nevojshëm për funksionimin e mirëfilltë të metodës kritike, etj.

1.3.1. Do theksuar këtu edhe pikëpamjen e Popperit për racionalizmin dhe irracionalizmin. Sipas Popperit, për dallim nga aracionalizmi, i cili është kritik, irracionalizmi priret drejt dogmatizmit (atje ku nuk ka argument, mbetet vetë pranimi i plotë ose mohimi kategorik). Kritika gjithnjë kërkon një shkallë të caktuar imagjinatë, ndërsa dogmatizmi e shtyp atë. Kështu, përderisa irracionalisti këmbëngul që emocionet dhe pasionet janë zemrë të veprimt njerëzor (shih për këtë edhe D. Hume) më shumë se arsyeja... Popperi mëson se në duhet të përpigemi që arsyeja ta luajë një rol më të madh.

Hume-i ka meritën e pavdekshme se guxoi të sfidoje pikëpamjen praktike për induksionin, megjithëse nuk dështoi kurrë se ajo duhet të jetë e vërtetë në një shkallë të madhe... Ai besonte se induksioni me anën e përsëritjes, logjikisht ishte i paargumentueshëm, se racionalisht ose logjikisht, asnjë sasi e rasteve të vëzhguara, nuk mund të ketë as lidhjen më të vogël me rastet e parvëzhguara. Kjo është zgjidhja negative e Hume-it për problemin e induksionit... (Shih: Popperi, vepra të zgjedhura).

eksperimentale, që kanë qenë sajuar me synimin për të kritikuar teoritë. Me një fjalë, në përpjekjet tona për të njohur botën ka vetëm një element racionaliteti: si është shqyrtimi kritik i teorieve tona, nënvizon Popperi, ndërkohë që vetë këto teori janë hamendje, parashtrim i tyre.

Monografi

Zymi i shtatë kodrave

Nikollë Kërhanaj, "Zymi i shtatë kodrave", Klubi letrar "Shtjefën Gjeçovi" në Zym të Hasit, 2008, f. 246

■ SHKRUAN:
Frrok Kristaj

Nikollë Kërhanaj tash e shumë dekada është i njohur në letrat tona me shkrime të

shumta letrare, publicistike, historiografike, etnografike etj. Ai shkroi shtatë vepra me rëndësi

të veçantë për letërsinë dhe për historiografinë tonë kombëtare, por këto ditë doli para le-

xuesve edhe me librin monografik "Zymi i shtatë kodrave". Libri i përmendur është një kapitull në veçantë monografike për të gjitha ato mbetje etnografike e historike në Zym, të cilat Kërhanaj tash e më shumë se 20 vjet i mbledh nga kujtesa e mplantur e bashkëfshatarëve tanë. Dhe, sikur të mos delte një kësisoj Nikolle që t'i mbledhte ato copëza etnografike, me siguri se edhe ato do të zhdukeshin, siç janë fshirë edhe shumë të tjera nga kujtesa e më të vjetërve tanë. Në këtë fushë, Kërhanaj punoi me vullnet dhe përkushtim të madh dhe kreu një borxh ndaj shumë zakoneve të të parëve tanë dhe zakoneve tona, por edhe regjistroi të gjitha ato personalitete të shquara, që i kontribuan avancimit të jetës, profesionit e mbi të gjitha çështjes fetare, arsimore, kulturore e në përgjithësi çështjes kombëtare. Kësisoj Kërhanaj është njohës i mirë i rrethanave të jetës, por edhe i figurave të kohës, që në një mënyrë apo në një tjetër lanë gjurmë. Fundja edhe Bibla na porositi se "jemi të thirrur që të lëjmë gjurmë në këtë jetë". Ndaj edhe ata që do të shprehin interesim ta lexojnë veprën monografike "Zymi i shtatë kodrave" të Nikollë Kërhanajt, këtë do ta bëjnë me një frymë dhe me kënaqësi të veçantë.


Jeta e një krijuesi, siç është Nikollë Kërhanaj, nuk është e rëndomtë: ajo i ka ringjalljet e saj të vazhdueshme e të veçanta. Dhe mbi këto ringjallje të motiveve, të valës së kujtimeve e të zjarrit të zgjuar në kujtime, ndriçon Nikolla si kandil i pashuar. Një dekada jete, ky njeri i urtë e ka thirrë në një sofrë të përbashkët kujtesën kombëtare dhe bashkëkohësinë, traditën dhe modernitetin; pra, ai ecën me ne, pranë nesh e shumë shpesh edhe pa nesh.

Dhe, tash kur ndalemi e mendojmë për një çast për shumë ngjarje, tribuna, manifestime, njohje e rinjohje nëpër shumë dekada; do të vërejmë se aty është dora e shpirti i një njeriu pa zhurmë e pa bujë. Aty, tek ajo

bukuri e gurtë zymjane, Nikollë Kërhanaj është shkrirë e është bërë një - trualli i shqipeve midis njerëzve, aty është bërë zjarr i ndjenjës së atdhedashurisë e i shpirtit të traditës, pikërisht në kohët më të rrëshqitshme, kur mund të binte keqas identiteti ynë. Aty, Nikolla me shokë, nuk i lanë të shpërndahen korifejtë e mëdhenj të Hasit që vigjëlojnë amshueshëm në ecjet tona, siç janë emrat e mëdhenj të Imzot Pjetër Bogdanit, të Atë Shtjefën Gjeçovit, të Atë Luigj Palajt, të Katarina Josipit, Anton Pashkut e shumë të tjerëve.

Nikollë Kërhanaj në radhë të parë dëshiron dhe synon t'i qëndroj besnik vetvetes. E, t'i qëndrosh besnik vetvetes, nuk do të thotë t'i ruash emocionet, fjalët, mendimet dhe të bëmat, po ta ruash të paprekur e të pashprishur natyrën e vetvetes, ato tipare të karakterit të njeriut të gurtë hasian, ngado që të ketë bredhur; ashtu si shtegtojnë nëpër gjithë dheun vetë zymjanët, por që e ruajnë atë tharm të identitetit të pashprishur. Ashtu, sikundër janë edhe vetë korifenjtë e mëdhenj të Hasit.

I dashuruar që herët në magjinë e traditës, Nikollë Kërhanaj e ruajti frymën e shpirtit të gurtë hasian, të prirjes përtej kufijve njerëzorë, të një sinqeriteti e krenarie të ruajtur fanatikisht në tharmet e brendshme të shprehjes e të shpirtit duke pushtuar hapësira të reja të identitetit, duke i ngulitur e përhapur këto rrënjë e degë të identitetit njerëzor, nacional e krijues. Dhe, së këndejmi, libri i tij vjen si kurorë e një përvore të gjatë shkrimore, si thesar e dhunti e kësaj përvore Nikollë Kërhanaj që aq shumë i ka dhënë mjedisit të truallit për të mos lënë asgjë në harresë, po për ta ringjallur në shumë forma e trajta deri te ringjallja. Ndaj, Kërhanaj është kronist i gjallë i ngjarjeve të kohës, duke i zënë me penën e tij të hollë të gjitha ato nyje zhvillimore që shënojnë dhe që cilësojnë thelbin e proceseve në kohë dhe hapësirë.



Thesar muzikor me frymëzim shpirtëror

Vinçenc GJINI, *Ejani t'i këndojmë Zotit I, II*, MKSH në Zagreb, 2000.

Krijimtaria e tij e madhe e kompozuar me një profesionalizëm dhe me një imagjinatë të madhe, ku akti estetik ravijëzon formën, konceptin metafizik dhe me të drejtë konstatojnë estetët dhe filozofët se "imagjinata paraqet, në konsekuencën e fundit, syrin e shpirtit.

■ SHKRUAN:
Akil Mark KOCI / Londër

Në rrugën e qitjes në dritë të muzikës sakrale

Shqyrtimet e mia modeste të deritanishme për muzikën sakrale shqiptare, mendoj se janë të vlefshme nga shumë aspekte, sepse për të parën herë paraqiten një sërë artikujsh për kompozitorët, që në opusin e tyre kanë edhe muzikë sakrale, dhe e dyta, do të kemi një pasqyrë më të qartë se sa kompozitorë kanë kompozuar dhe sa vepra janë krijuar deri tash në universin e krijimtarisë muzikore sakrale shqiptare, në këtë sferë të pahulumtuar sa duhet, dhe, së fundit, cilat janë ato vepra dhe sa janë ato kualitative.

Deri tani në këto shkrime nuk kam bërë krahasime mes krijimeve dhe autorëve të tyre, por kam bërë vlerësime në kuadrin e veprës dhe opusit krijues individual të çdo autori, sepse reflektimet e mia kritike për veprat janë ngushtë të lidhura me mendimin tim estetik dhe artistik. Prandaj për të dhënë vlerësime të tilla, natyrisht do të duhet një analizë më e thellë muzikologjike, bazuar në kodet relevante shkencore. Kriteri estetik është i nevojshëm kur kemi parasysh edhe pluralitetin e mendimeve të kolegëve dhe të muzikologëve të tjerë, që paraqitet si strukturë komplekse në

artin e përgjithshëm muzikor. Kjo gjini muzikore është lënë pas dore për një kohë të gjatë, për shumë shkaqe, të cilat i kemi përmendur disa herë. Porse ajo, s'ka dyshim, meriton një vështrim dhe studim më të gjerë dhe të gjithmbarshëm nga ekspertë të shumë të muzikologjisë, dhe jo vetëm në aspektin e muzikologjisë, por edhe në aspektin filozofik, artistik dhe estetik.

Nga studimet e mia për këtë fenomen kam ardhur deri te konstatimi se muzika sakrale nuk ka pasur ndonjë zhvillim sikurse në vendet e tjera me tradita të mëdha muzikore. Kjo ngetje ose moszhvillim është ndikuar për shkak të robërisë pesëshekullore otomane, e më vonë, edhe për shkak të regjimit komunist. Duket e natyrisht që ajo "mos" kishte merr përmasa më të gjera zhvillimore, që ka ndikuar dukshëm në moskrijimin e vlerave,

do të jenë edhe një kontribut i vogël duke synuar të jetë, si të themi, një qasje, një kujdes që duhet kushtuar kësaj gjinie aq deficitare muzikore ndër ne. Këto krijime mund të shkaktojnë ndonjëherë edhe përjetime të thella emocionale si përsosmëri jo vetëm krijuese, por edhe estetike, intelektuale dhe morale, duke bartë në vete forcën ekspresive, të cilat, në këtë kohë të detronizuar në çdo aspekt, mund të pastrojnë, t'i lartësojnë shpirtërat njerëzore ose, si do të thoshin shkrimtarët dhe filozofët, "e ndihmojnë njeriun të kuptojë vetveten".

Pasi deri tani s'i kemi kushtuar kujdes të duhur muzikës sakrale, na duhet bërë shumë që të angazhohim gjithë potencialin krijues dhe interpretues e t'i animojmë për një kultivim sa më qenësor të trashëgimisë kulturore të muzikës sakrale dhe për një

perspektivë më të qartë të saj, duke biseduar me kompozitorët dhe shkrimtarët, që kësaj gjinie të i kushtojnë kujdes më të madh se deri tani në krijimtarinë e tyre.

Në këtë drejtim kultivues

veproi edhe kompozitori Vinçenc Gjini, i cili na solli dy botime me muzikë sakrale me vlera të pakontestueshme si krijime që do ta begatojnë fondin e kësaj gjinie.

Kush është Vinçenc Gjini

V. Gjini u lind në Ferizaj më 22

janar në Ferizaj, u diplomua në seksionin teorik të Akademisë muzikore të Beogradit, kurse në Shkup studioi kompozimin dhe është magjistër i harmonisë.

Ka një opus mjaft të madh dhe pos tri simfonive, simfonietës, 10 Kantatave, sonatë për violinë dhe piano; ka edhe shume vepra të tjera të gjinive dhe të formave të ndryshme, kurse gjuha e tij muzikore është "e qartë, me simetri dhe ekuilibër klasik, me harmoni neo-romantike me përdorim të shpeshtë të bazës tonike modale dhe mjaftë herë me tingëllim të melosit popullor shqiptar". Është gjithashtu autor i një numri të konsiderueshëm veprash të muzikës kishtare. Në vitin 2000 e boton veprën e tij kapitale të muzikës sakrale në dy vëllime "Ejani t'i këndojmë Zotit - I dhe II, botim i Misionit katolik Shqiptar në Zagreb, nën përkujdesjen e misionarit Don Ndue Ballabani. Siç shkruan në CV (curriculum vitae) e tij, është profesor i parë muzikor me kualifikime të larta dhe është kompozitori i parë në Kosovë që ka kompozuar meshën në gjuhën shqipe. Jeton dhe vepron në Buje të Kroacisë.

Opusi krijues

Tani kam në dorë dy librat voluminozë të Vinçenc Gjinit, protifesorit dhe kompozitorit tonë të shquar shqiptar, me titull "Ejani t'i këndojmë Zotit I, II" me këngë sakrale, por nuk e kam pasur më lehtë të shkruaj dhe të rrefej për opusin, më mirë të themi, për thesarin krijues të tij.

Shpesh jam takuar me krijimtarinë e tij, qoftë atë pedagogjike ose krijimtarinë muzikore, për

të cilat kam shkruar disa herë, duke u bazuar në prirjen e tij për të krijuar vepra të reja me vlerë, përqendrimin dhe vëmendjen brenda strukturës muzikore, shkrijen e ndjenjave të autorit në skematizmin krijues, konceptin artistik që e hasim në veprat e tija, të cilat vezullojnë para nesh si bukuri plotë domethënie të trupëzuara dhe të perceptuara si tipare qenësore, ngase ato shquhen gjithmonë me një kompozicion plotë melodi, ritme dhe me shumë harmoni, pse jo edhe me një arkitektonikë të qartë, vërtet mjeshtërore të përvetësuar estetikisht, bazuar në specifikat e artit. Kjo harmoni elokuente nuk është edhe i thjeshtë, sepse hasim në një lidhje logjike, fakte që konvertojnë mes veti, jo vetëm në fokus për ta paraqitur thelbin e idesë kryesore, por edhe universin dhe universalen e saj estetike si formë e shprehjes origjinale. Pra, ato nuk janë kompozime të krijuara në bazë të parimeve skematike abstrakte, por vepra me një imagjinatë të thellë, bazuar në përjetime estetike, vepra të mirëfillta artistike. Gjithmonë, si krijues, koleg dhe mik i tij, kam pasur një respekt dhe ndjenjë të thellë për krijimtarinë e këtij kompozitori, pavarësisht prej mendimit krijues estetik muzikor, divergencave të tyre thelbësore që i takojmë thuaja dy stileve, ose më mirë te themi shprehjeve muzikore krijuese si dhe bisedave të shumta në lidhje me/për muzikën, shpesh edhe për çështje të artit, duke shkëmbyer mendime kontradiktore mes vete, por gjithnjë pa "zjarr" gjatë bisedave e diskutimeve krijuese, sepse "arti nuk

Vinçenc Gjini i takon gjeneratës së parë të pedagogëve shqiptarë me Akademi muzikore të kryer në Beograd. Ka qenë i veçantë jo vetëm për kah rezultatet e arritura gjatë studimeve, por edhe për kah krijimtaria e tij e madhe, e kompozuar me një profesionalizëm dhe me një imagjinatë, ku akti estetik ravijëzon formën, konceptin metafizik.

jo vetëm muzikore, morale por edhe të atyre artistike, e aq më pak të vlerave shpirtërore që ndikojnë si faktorë nxitës përmes përsosmërisë shpirtërore, duke qitur në pah të vërtetën, të bukurën dhe të mirën.

Prandaj, vështrimet e mia botuar në revistën "Drita", ndoshta

është vetëm fotografim i ideve, por edhe vlerësim aksiologjik nga shumë aspekte”.

Vinçenc Gjini i takon gjeneratës së parë të pedagogëve shqiptarë me Akademi muzikore të kryer në Beograd. Ka qenë i veçantë jo vetëm për kah rezultatet e arritura gjatë studimeve, por edhe për kah krijimtaria e tij e madhe, e kompozuar me një profesionalizëm dhe me një imagjinatë, ku akti estetik ravijëzon formën, konceptin metafizik. Pra, në këtë kuptim e kam më lehtë të jap vlerësime, analiza për këto dy libra përplot krijime të bukura dhe të flasë për këto pjesë muzikore të mishëruara jo vetëm artistikisht, por edhe në aspektin estetik, duke e pasur të qartë krijimtarinë e tij të madhe, që bazohet në sintagmën se “artin për ta shijuar me ndjenja, duhet ta perceptojmë me shqisë”, gjë që më ka rastisur shumë herë, sepse kam pasur në dorë partiturat e tija si dhe kam dëgjuar mjaft muzikë të kompozuar, qoftë në ekzekutime të “galla-live”, qoftë edhe përmes incizimeve. Kompozimet e tij emitoeshin rregullisht përmes valëve të Radio Prishtinës, të cilat më kanë lënë mbresa të thella, sepse me sukses e lidh të bukurën me formën ta quajmë “klasike” në kuptime të gjëra, të cilës me aq përpikni jo vetëm që e respekton, por edhe i përmbahet gati në të gjitha kompozimet e krijuara, dhe të cilat shquhen me melodikë të pasur, ritëm të gjallë dhe harmoni të bujshme. Kështu krijon një muzikalitet të spikatur që përcaktohet herë nga lirizmi i gjerë e herë edhe nga drama e thellë, duke shprehur dhe ngritur karakterin emocional si shkrirje e ndjenjave individuale të këtij krijuesi, të ndërthurura me lirizmin dhe introspeksionin si forcë shprehëse.

Kjo, pra ka qenë ndihmëse e madhe për ta parë, përcjellur dhe analizuar krijimtarinë e tij të pasur, kurse për këto dy libra që paraqesin një pasuri muzikore, jo vetëm në muzikën sakrale shqiptare, por edhe në tërësinë e krijimtarisë muzikore shqiptare si pjesë integrale e saj. Tek këto libra kam vërejtur vlerën tradicionale të krishterimit i frymëzuar nga Ungjijtë sipas Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit ku rrëfejnë, pos të tjerash, edhe një dashuri universale, pavarësisht, te të gjithë njerëzit pa dallim feje dhe kombi.

Libër i tingujve të gjallë

Për të pasur një njohuri më të madhe me siguri se do të më ndihmojnë shkrimet e tri personaliteteve të shquara muzikore të Kroacisë dhe sidomos fjala hyrëse e Don Ndue Ballabanit, misionarit të Misionit Shqiptar në Kroaci, i cili në rolin e botuesit na paraqitet në parathënie e vet të gjerë me një retorikë e vetë plotë elokucencë nga këndvështrimi i tij, i cili fokuson dhe sugjeron imazhin e përgjithshëm eterik që paraqet refleksin e një strumbullari estetik dhe etik,

“Me këto kompozime – V. Gjini - zgjon dhe ngrit jetën shpirtërore përmes këngës, në ceremonitë fetare, duke e gjallëruar dashurinë ndaj Hyjit dhe përjetimin e thellë të vetëdijes nacionale dhe religjioze të popullit shqiptar, i cili është i shpërndarë nëpër botë, por i cili është i lidhur me traditën e shenjtë të Kishës katolike, si gurrë e së vërtetës që duhet besuar e si normë morale që duhet ndjekur.”

Don Ndue Ballabani

të këtyre dy librave, siç thotë “se këto dy libra do të jenë kontribut i madh për kulturën e përgjithshme gjithë kombëtare shqiptare, por, njëkohësisht edhe rrugë e hapur për krijime të reja”. Ai na njehtë edhe me përvojën empirike dhe për pikëpamjet e para fetare ndër ne, pa mistifikime, por në emër të kujdesit për shpirtin, të lumturisë së amshuar dhe të shpëtimit të shpirtit, duke ringjallë dhe duke ngritur artistikisht këngën liturgjike dhe siç thotë “me tinguj të gjallë ta zgjojë dhe ta ngrit jetën shpirtërore përmes këngës, ceremonive fetare duke e gjallëruar dashurinë ndaj Hyjit dhe përjetimin e thellë të vetëdijes nacionale dhe religjioze e popullit shqiptar i cili është i shpërndarë nëpër botë por i cili është i lidhur me traditën e shenjtë të kishës katolike, si gurrë e së vërtetës që duhet besuar dhe me normat e saj morale që duhet mbajtur”. Pra, bazuar jo vetëm në doktrinat kishtare, por edhe ato artistike dhe estetike, këngës asaj solistike dhe korale liturgjike i është dhënë gjithnjë përparësi, sepse bartin elementet e rëndësishme për forcimin jo vetëm të këngës liturgjike, por edhe atë fetare, sepse në Ungjillin Shenjtë thuhet “ai kush këndon dy here i lutët Zotit”.

Qëndisje e përvojave më të mira të kompozimeve evropiane

Pra, pos këtij teksti në marginat e kopertinave kemi dy ekstraktet e dy recensioneve të dy profesionalistëve të njohur kroatë, të Dr. Miho Demoviq, Regens kori i katedrales së Zagrebit dhe Mr. mo Miroslav Martinjak, profesor në fakultetin Teologjik katolik në Zagreb.

Në ekstraktin e Dr. Miho Demoviq thuhet: “Kantuali i kompozimeve kishtare në gjuhën shqipe ‘Ejani t’i këndojmë Zotit, libri I dhe II i prof. mr. Vinçenc Gjini-t duhet theksuar si risi që shkakton



“babi” me vëllimin e tij. Autori në kompozime sikur t’i kishte qëndisë të gjitha përvojat më të mira të kompozimeve evropiane gjatë shekujve. Kjo vepër monumentale mund të konsiderohet edhe si punim pionier në fushën e muzikës kishtare në gjuhën shqipe. Në secilin kompozim autori manifestohet si njohës i përsosur i stilit vokal, i harmonisë, i drejtimit dhe konstruktimit natyral të vijës melodike. Duke vëzhguar në tërësi V. Gjini ka krijuar opus të rëndësishëm të këngëve kishtare të vrullshme, të këndshme dhe të përzemërta dhe me vepërën e vet e ka pasuruar Kishën Katolike me thesar të kompozimeve shpirtërore.”

Pra një shkrim në pikëpamje profesional shumë të qëlluar, por do të bënim një vërejtje se nuk është punë pionieri e këtij krijuesi, por edhe në muzikën sakrale shqiptare në përgjithësi, ngase nuk e njeh sa duhet krijimtarinë e kompozitorëve shqiptarë, se përpara gjeneratës tonë muzikë sakrale kanë kompozuar At Martin Gjoka, Kardinali Mikel Koliqi dhe shumë të tjerë, kurse për Kosovë mund të jetë pionier i muzikës sakrale Lorenc Antonini, Vinçenc Gjini, Akil M. Koci, Zeqirja Ballata, Rruf Dhomi, Gjon Gjevelekaj dhe të tjerë.

Kurse në ekstraktin e Miroslav Martinjak, është tejet pozitiv: “Çdo thesar muzikor i një populli

shfaq kulturën e tij, veçmas thesari muzikor i inspirimit shpirtëror-religjioz është shprehje e fesë dhe e pjekurisë shpirtërore të atij populli. Mund të thuhet: ‘si këndon populli ashtu edhe beson, sepse kënga fetare buron nga thellësia më e madhe e ndjenjës njerëzore, nga atje ku njeriu takohet me Zotin. Kantuali ‘Ejani t’i këndojmë Zotit’ dëshmon forcën e fuqishme krijuese të muzikantit shqiptar, kompozitorit Vinçenc Gjinit, i cili bëri përpjekje të madhe për t’i dhuruar popullit të vet një pasuri që nuk paguhet. Pasuri e inspirimit shpirtëror që do t’i përcjellë ceremonitë dhe të kremtet në gjuhën shqipe. Shpirti që shkëlqen nga këto kompozime vërteton gjendjen e V. Gjinit në kulturën muzikore katolike të civilizimit evropian dhe njohjen e të kompozuarit të teknikës së motetit për koret dhe nevojat liturgjike. Fjalët liturgjike, në kompozimet e Gjinit i është dhënë përparësi dhe muzika i shërben fjalës e jo anasjelltas. Kompozimet e dedikuara koreve janë të krijuara në teknikën e përshatshme, me pretenime jo të tepërta, por prapë mjaft efektive dhe melodike. Gjithsesi kjo vepër është pasurim i madh i liturgjisë muzikore shqipe e trashëgimit të krishterë dhe përpjekje e madhe e kompozitorit Gjini është dhuratë e madhe e popullit të vet, i cili me anë të atyre kompozimeve në liturgji e lavdëron Zotin dhe e shuguron në jetën e vet të krishterë.”

Kurse në parathënie Don Ndue Ballabani thotë: “Me nxitje për krijimtarinë e muzikës sakrale, si sintezë e jetës shpirtërore, më se të nevojshme për ne, përmes së cilës adhurohet dhe lartësohet Hyji, e besimtarët të përshkruar me fuqinë e saj magjike e njohin bukurinë dhe dashurinë shpirtërore, prof. mr. Vinçenc Gjini iu përvesh punës serioze dhe krijoi një opus të konsiderueshëm kompozimesh të reja origjinale kishtare në gjuhën amtare shqipe, të cilën do ta gëzojmë ne dhe pa-

sardhësit e Kishës sonë. Për arsye se libri është voluminoz, ai është ndarë në dy vëllime: “Ejani t’i këndojmë Zotit I” dhe “Ejani t’i këndojmë Zotit II”, ku janë përfshirë 312 kompozime. Në librin –vëllimi i parë, këngët renditen si vijon: Lutjet themelore, Meshë të kënduara, Këngë eukaristike, Këngë për të cilat gjatë vitit kishtar dhe Këngë për kremte të Shenjterve. Në vëllimin e dytë: Të Adhurit (Adventi), Krishtlindja, Kreshmët, Pashkët, Jezu Krishti, Zojës së Bekuar (Virgjinës Mari) dhe Këngë rasti.

Për shkak të mungesës së teksteve të reja, autori gjatë kompozimeve ishte i kufizuar kryesisht në tekstet e librave: “Të lëvdojmë Zotin së bashku” (p. Hil Kabashi), Shujtja shpirtërore” (Dr. don Gasper Gjini), “Kantuali kishtar shqiptar” (Mons. N. Mini), “Meshari” dhe Bibla (përkthim i mons. Simon Filipaj). Shihet se shqipërimi i shumë teksteve është marrë nga imzot Hil Kabashi. Njëkohësisht hasim edhe në tekste të reja. Kjo është vepër e parë origjinale e pavarur e këtij lloji e prof. mr. Vinçenc Gjini.

Kjo vepër do të jetë kontribut i madh për kulturën gjithëkombëtare shqiptare, por njëkohësisht, edhe rrugë e hapur për krijime të reja.

Tendencat e autorit ka qenë ringjallje dhe ngritja artistike e këngës liturgjike tek ne. Kurse dëshira dhe qëllimi primar i këtyre kompozimeve, është që besimtarët me këngë liturgjike dhe me tingull të “gjallë” ta zgjojë e ta ngrit jetën shpirtërore dhe bashkërisht të marrin pjesë në ceremonitë fetare, si dhe të mbërrin ripërtëritja dhe identiteti shpirtëror e kulturor. Përveç kësaj, qëllimi është që sa më shumë pasurohet dhe të zgjerohet fondi i raportit të muzikës sonë korale kishtare, kështu që të gjallohet dashuria ndaj Hyjit dhe përjetimi i thellë i vetëdijes nacionale dhe religjioze e popullit shqiptar, i cili është shpërndarë nëpër botë. Populli shqiptar është ngushtë i lidhur me traditën e shenjtë të kishës katolike, si gurrë e së vërtetës që duhet besuar dhe me normat e saj morale që duhet mbajtur.”

Dhe për fund, të më lejohet të shtoj se Misioni Katolik Shqiptarë në Kroaci, me misionarin Don Ndue Ballabani, zhvillon një aktivitet të madh në mbajtjen e tubimeve shkencore, simpoziumeve dhe manifestimeve, jo vetëm kishtare, por edhe të aktivitetit të tjera nga historia jonë kombëtare. Veçanërisht Misioni shquhet me botimin e shumë veprave të studiuesve shqiptarë nga të gjitha sferat, qofshin ato shkencore, artistike, estetike, filozofike fetare, por edhe nga ato laike. Edhe këto dy vëllime të muzikës sakrale janë kontribut i madh i këtij Misioni e sidomos i angazhimit shumë të madh të meshtarit dhe misionarit Don Ndue Ballabanit.

(Nëntitujt janë të redaksisë)

